

Për ExLibris flet nga Japonia albanologu Ichiro Iura

ICHIRO IURA:

LEXUESIT JAPONEZ I PËLQEJNË PASURIA DHE LARMIA E LETËRSISË SË SOTME SHQIPE



Bisedoi Andreas Dushi

NURIE EMRULLAI
DIONIS PRIFTI
LEDIAN GJEÇI
FITUESIT E 'FONDIT
MBËSHTETËS TË
KRIJIMTARISË LETRARE
PËR TË RINJ' NGA QKLL

SHËNIME PËR LIBRAT

"Hije në grila" i Eqrem Bashës,

**HANI I UDHËTARËVE
PLANETARË**

Nga Ali Aliu

(fq. 8)

"Kutia e Agatha Christie-t" i Mira Meksit

**ETHE DHE
NJËKOHËSISHT MREKULLIM**

Nga Diana Çuli

(fq. 9)

"Thika pa gjak" i Zija Çelës

**BUKURIA E RRËFIMIT DHE
LARMIA E SUBJEKTEVE**

Nga Halil Rama

(fq. 10)

Resul Shabani: "Mëkat i trilluar"

**IDENTITETI I SË
PËRGJITHSHMES**

Nga Shaban Murati

(fq. 11)

**KANUNI DHE
"PRILLI I THYER"
I KADARESË**

Nga Mehmet Elezi

(fq. 12)

Shkrimi i Namik Ressulit dhe përgjigja e Filip Fishtës
për periodizimin e letërsisë shqipe

GEGËRISHTJA APO TOSKËRISHTJA?


(fq. 5)

Në numrat e parë të revistës "Shëkundija", themeluar e drejtuar nga Ernest Koliqi, zhvillohet një ndër debatet më interesante rreth periodizimit të historisë së letërsisë shqipe, ai mes Namik Ressulit dhe Filip Fishtës.

TË NGRATËT PËRKTHYES TË MIRË

(fq. 22)

Gabriel G. Márquez



BIBLIOTEKË

Vehbi Skënderi

(fq. 16)

Thuaja hënës

Teresa Palazzo Conti

(fq. 18)

Kopsht i akullt

Yolanda Pantin

(fq. 19)

Unë jam tjetër

Ardiana Salihu

(fq. 20)

Të bërë e të pabërë

Roland Gjoza

(fq. 21)

Portreti

Søren Kierkegaard

(fq. 23)

Ditari i ngashnjyesit

**NJË SKICË E PROMETEIKES
NË LETËSINË SHQIPE, NGA
DE RADA TEK PORADECI**

Nga Skënder Karriqi

Kur është fjala për shtjellimin e temës prometeike në letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë, që në fillim ndeshesh me mungesën e pranisë së drejtpërdrejtë të heroit mitologjik, titanit Promete...

(fq. 14)

ICHIRO IURA:

LEXUESIT JAPONEZ I PËLQEJNË PASURIA DHE LARMIA E LETËRSISË SË SOTME SHQIPE

Bisedoi Andreas Dushi



Klosi. Prandaj fitova një mundësi për t'u ligjësuar studentëve japonezë për gjuhën shqipe në kornizën e gjuhësisë "historike" dhe "indoevropiane". Në kursin kanë marrë pjesë rreth tridhjetë studentë në çdo semestër. Aty kanë marrë njohuri jo vetëm për gramatikën e shqipes, por edhe kulturën e Shqipërisë (edhe pjesë-pjesë atë të Kosovës). Por fatkeqësisht, pas riorganizimit të fakultetit, ky kurs mori fund për shkak të mungesës financiare.

Prej vitit 2011 jam drejtori i shkollës private të lartë për studentët e huaj. Këtu zhvillohen kurset e gjuhës japoneze për studentët që përgatiten për të hyrë në universitet. Pranë kësaj pune, po merrem me përkthimin e letërsisë shqipe. Një pjesë e përkthimeve e kam botuar ose në formën e librit, ose në internet.

A.D: Po interes, ka? Pra studentët, vendosin të studiojnë për gjuhën apo letërsinë shqipe?

A.D: Zoti Ichiro, është vërtetë e veçantë: një albanolog japonez! Çfarë ju lidh kaq shumë me Shqipërinë, një vend jo edhe aq i madh, ndikimi i të cilit nuk ndihet aq shumë?

I.I: Fillimi ishte interesimi për gjuhën, më shumë se 30 vjet më parë. Atëherë kisha filluar të studioja gjuhësinë në fakultet. Gjatë mësimit të gjuhës greke antike, fillova të mësoja gjuhët e tjera ballkanike si bullgarishten, rumanishten etj. Kur arrita në mësimin e gjuhës shqipe, më ka vënë vëmendjen karakteristikat dalluese gjuhësore. Më pas, jam njohur me kulturën shqipe pranë studimit në fushën e gjuhësisë.

A.D: Ju keni drejtuar katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Hiroshimës në Japoni. A njihet kultura shqiptare atje?

I.I: Me saktësi; në dekadën e fillimit të këtij shekulli, kam qenë në katedrën e gjuhësisë të fakultetit të letërsisë të Universitetit të Hiroshimës, në të cilën kam zhvilluar leksionet e gjuhës shqipe. Në ato kohë kjo katedër është e shquar me studimet e gjuhësisë filologjike. Unë sapo isha kthyer nga Mynihu, Gjermani, ku pata marrë pjesë në seminarin e albanologjisë të drejtuar nga Wilfried Fiedler dhe Ardian



II: Siç e përmenda më lart, tani nuk më ka komunikim me studentët që kanë marrë në kursin tim.

Shpresoj se ata vazhdojnë të mbajnë të pandryshuar interesin për gjuhën e letërsinë shqipe.

A.D: Kur vendosët t'i përkushtoheshit me kaq seriozitet shqipes e Shqipërisë, ndjetë ndonjë frikë mos ndoshta s'do të merrnit *feedback*-un e dëshiruar ngase njerëzve nuk do tu interesonte ç'ndodh me kulturën apo letërsinë e një vendi të vogël e tejet të largët?

II: Në fundin e viteve '80 nuk ka patur mundësi për të vizituar Shqipërinë. Në ato kohë, Shqipëria ishte tepër larg meje. Më kujtohet se e kam vazhduar mësimin e shqipes vetëm për një pjesë të gjurmimeve ballkanologjike. Që kur nga viti 1995, kur bëra vizitën e parë në Shqipëri, duke thelluar miqësinë me shqiptarët, jam angazhuar në albanologjinë më intenziv, por në mënyrë të ngadalshme. Frikën... s'e kam patur asnjëherë! Në të vërtetë, këtu në Japoni s'ka koleg që punon në të njëjtën fushë. Por, jashtë Japonisë, po ekziston komuniteti ndërkombëtar i albanologëve. E kam ndjerë ekzistencën e tij jo vetëm në Shqipëri, edhe në Kosovë, Gjermani, Austri. Edhe tani ndiej se po gjendem në këtë komunitet të madh... pra, në një cep të largët të sallës.

A.D: Po historia e katedrës së gjuhës shqipe në universitetin e Hiroshimës, cila është? E keni themeluar ju, apo dikush tjetër më heret?

II: Siç e përmenda më sipër. Ishte një veprim jetëshkurtër, por një përvojë e pazëvendësueshme për mua.

A.D: Nëse keni informacion, a kanë universitetet e tjera japoneze katedra kushtuar gjuhës tonë?


II: Mendoj jo, më vjen keq. Por, në Universitetin e Tokios mbeten disa profesorë që janë marrë me programin e studimeve ndërdisiplinore për historiografinë të Evropës juglindore pas viteve '90 (edhe unë kam marrë pjesë në atë program). Ka mundësi që studentë mësojnë shqipen nga nevoja për të lexuar tekste.

A.D: Falë punës tuaj, janë përkthyer nga gjuha origjinale shqipe autorë të rëndësishëm shqiptarë si Ismail Kadare apo Ylljet Aliçka. Si është pritur në Japoni letërsia shqipe?

II: Në Japoni ka një grumbull i dashuruesve të letërsisë botërore. Midis këtyre "tifozeve", Ismail Kadare është një nga autorët më të njohur. Disa vepra të tij janë përkthyer në gjuhën japoneze, shumica e të cilave janë përkthimi nga frëngjishtja. Në internet e kam shfaqur përkthimet e tregimeve si "Ëndrra mashtruese" dhe "Përbindëshi" që s'ishin aq të njohur ende në Japoni. Sapo e mbarova përkthimin e romanit "Dimiri i vetmisë së madhe". Këto janë pritur pozitivisht nga lexuesit japonezë që njohin mirë rëndësinë e Kadaresë. Tregimin e Ylljet Aliçkës "Parrullat me gurë" e përktheva në kohën kur filmi me të njëjtin titull u vlerësua me Çmimin e Artë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tokio më 2001. Shumica e lexuesve ishin njerëzit që kanë treguar interes për filmin.

Përveç kësaj, shpresoj se do të bëhen më të njohur autorët e tjerë si Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Fatos Kongolli, Viktor Canosinaj, Ermir Nika etj., veprat e të cilëve i kam përkthyer pjesërisht. Si rezultat i punës, "I humburi" i Kongollit u botua një vit më parë, ka dalë në qarkullim. Tani përgatitem për përkthimin e romanit "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", po rastësisht në kohën kur do të shfaqet një film i "shokut Zylo".

A.D: Ndonëse falë internetit bota është kthyer në një fshat të vogël, sërish mbetet perceptimi se largësia mes Shqipërisë dhe Japonisë është shumë



e madhe, ndaj mund të ndodhin ngjarje të cilat mbeten pa u marrë vesh. Kështu që, lejomëni t'ju pyes nëse ka studime për letërsinë tonë? Po aktivitete kushtuar asaj si përshembull promovime a konferenca?

II: Në Japoni studimet për letërsinë shqipe mund të zhvillohen në kornizën e studimeve për letërsi evropiane. E njoh se në Tokio e Kioto janë zhvilluar disa seminare apo simpoziume të vegjel, në një të të cilëve një profesore ka mbajtur një kumtesë lidhur me letërsinë shqipe. Ajo ka hapur përkthimin e tregimit "Kopshti" të Ernest Kolliqit në një antologji të letërsisë botërore (Nuk e di nëse e ka përkthyer nga shqipja).


A.D: Kam vërtetë interes të di, çfarë vlerëson më shumë lexuesi japonez nga elementët e letërsisë shqipe?

II: Lexuesit japonezë i pëlqejnë, unë mendoj, pasuria dhe larmia e letërsisë shqipe së sotme. Ata shikojnë me çudi dhe me adhurim, se kjo karakteristikë ka ekzistuar në një vend kaq të vogël, i cili ka qenë në kampin socialist, madje në të ashtuquajturin "izolim". Në romanet e autorëve si Kadare, Agolli, Kongoli, mund të shikojmë jo vetëm elemente lokale (apo rajonale), por edhe ato universale.

A.D: E parë nga prespektiva juaj, si është sot gjendja e letërsisë shqipe? Kush janë autorët kryesorë të saj?

II: Kaloi tridhjetë vit pas rrënies së diktaturës, kultura e botimeve ka shtrirje të madhe në hapësirë. Është e vështirë të ndjek të gjithë rrymë letrare. Për mua, përveç Kadaresë, Fatos Kongoli dhe Dritëro Agolli mbeten autorët kryesorë për mua. Këta të dyja janë mjaft të shquar në zonën shqipfolëse, pa tjetër. Por duhet të "zbulohen" dhe njihen më mirë jashtë Shqipërisë, kryesisht në Azi.

Përsa i përket autorëve në fillim të shekullit XXI, unë lexoj jo sistematikisht, por sipas shijes sime personale. Këto ditë kam interesin për vlerësimin ndaj librit "Flama" të Tom Kukës. Ka mundësi të mirëpritet ky roman edhe në Japoni, ku ka histori dhe traditë e gjatë të romaneve detektive, ashtu si në Britaninë e Madhe.



Ichiro Iura u lind më 9 shkurt 1968 në Fukuka, Japoni. Shkollën e mesme e kreu në Gjinnazin në Okayama në vitin 1986, bachelor-in në Kyushu University, Fakultetin e Shkencave Natyrore, dega e Biologjisë, në vitin 1991, pastaj studimet pasuniversitare në Hiroshima University, Fakultetin Filozofik, Institutin e Gjuhësisë, deri në vitin 1998. Rotary International Foundation Scholar në Ludwig-Maximilians-Universität München, Institut für allgemeine und indogermanische Sprachwissenschaft (Albanologie), nga viti 1995 deri 1996. Magjistri (gjuhësi) në vitin 1994, Ph.D. (letërsi) në vitin 2001. Research Fellow of the Japan Society for the Promotion of Science nga viti 1998 deri 2000.

Që nga viti 1998 deri 2010 referoi gjuhën gjermane në Hiroshima Bunkyo Women's University, nga viti 2001 deri 2005 gjuhësinë historike dhe gjuhën shqipe në Hiroshima University, nga viti 2003 deri 2004 gjuhën gjermane në Hiroshima Bunka Gakuen University, nga viti 2004 deri 2006 gjuhën gjermane në Hiroshima College of Medical Technology, nga viti 2004 deri 2005 gjuhën gjermane në Kure National College of Technology, nga viti 2004 deri 2008 gjuhën japoneze (për studentët e huaj) në University of Shimane. Nga viti 2011 si zv/drejtor, nga 2014 deri tani punon si drejtor në shkollën private të lartë Fukuyama International Academy of Languages (shkolla e gjuhës japoneze për studentët e huaj) në Hiroshima.

Mes veprimtarive kryesore shkencore, dallohet si anëtar i Linguistic Society of Japan, anëtar i Linguistic Society of West Japan dhe anëtar i Japan Society of Greek Linguistics and Literature.

Ka disa botime në gjuhën japoneze, si për shembull "Fjalor japonisht-shqip (autor: Berat Zimberi), Shkup 2010 (korrigjues në japonisht)" apo "Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler, Verlag Dr.Kovač, Hamburg 2005". (bashkautor)

Ndërsa më kryesoret, janë:

Albania International, Shakaihyoronsha, Tokyo 2009.

Gjenerali i ushtrisë së vdekur (autor: I. Kadare), Shoraisha, Kyoto 2009. (përkthimi nga shqipja)

I humburi (autor: F. Kongoli), Shoraisha, Kyoto 2020. (përkthimi nga shqipja)

A.D: A është ajo sot në gjendje të qëndrojë dinjitoze përballë lexuesit të një tjetër kombi, e aq më tepër të një kombi si Japonia me të cilin, vlerësuar nga sipërfaqja, nuk gjenden shumë pikëtakime?

I.I: Është në një gjendje të tillë, pa tjetër! Mosngjashmëria në sipërfaqen midis dy kombeve, nuk është as pengesë, as problem. Në letërsinë shqipe mund të gjejmë përvojë bashkëkohore, gëzimet e vuajtjet njerëzore, që ka vlerë, ka rëndësi të njëjtë për të gjithë. Në të vërtetë, në vendin tonë, gjatë këtyre 75 viteve, s'kemi jetuar nën regjimit totalitar, s'jemi përfshirë në konflikt rajonal. Por absurditeti enigmatike që shikohet në figurat të veprave e Kadaresë ose Kongolit, burokraci qesharake që satirizohet në ato të Agollit, këto u zgjojnë simpatinë edhe lexuesve japonezë sot. Këtu s'ka nevojë për koment për kontekst historik. Po mbetet vetëm një pengesë e pashmangshme; largësia gjuhësore. Unë, si një përkthyes, përpiqem të heq perden (apo murin?) e trashë për t'u dhënë tejdukshmërinë lexuesve.

A.D: E për të ardhmen e letërsisë tonë çfarë mendoni?

I.I: Më duket se ka kaluar mjaft koha për të provuar "rishikimin" letrare ndaj jetës personale në kohën e diktaturës. Po tani, shikoj se si autorët e rinj do të vlerësojnë kohën e tranzicionit të viteve '90, në të cilën ka tërbuar kaosi me shpresa e zhgënjime. Sepse e vizitova shpesh Shqipërinë pikërisht në atë periudë. Këto pikëpamje, akoma nuk janë njohur mirë në Japoni.

A.D: Kontributi juaj për t'i dhënë zë një gjuhe të vogël sikurse është shqipja meriton një vlerësim të madh e të paçmuar. E keni ndjerë këtë vlerësim?

I.I: Po, gjithëmonë. Tani ju falënderoj që më dhatë shansin për të shfaqur mendimin tim. Më kënaq kur e pranoni me respekt përpjekjen time për të folur apo shkruar shqip. Shpresoj se përpjekja ime, akoma e vogël, do të kontribuojë për prezantimin e vlerës më të mirë të krijimtarisë në letërsinë shqiptare

Në numrat e parë të revistës “Shëkndija”, themeluar e drejtuar nga Ernest Koliqi, zhvillohet një ndër debatet më interesante rreth periodizimit të historisë së letërsisë shqipe, ai mes Namik Ressulit dhe Filip Fishtës.

GEGËRISHTJA APO TOSKËRISHTJA?

Shkrimi i Namik Ressulit dhe përgjigja e Filip Fishtës
për periodizimin e letërsisë shqipe

Gegërishtja apo Toskërishtja?¹

Nga Namik Ressuli

1. - Në një artikullin t’im botuar nja motmot ma parë në shtyllat e revistës “Shkolla Kombtare”, u paraqisja të gjithë atyreve që merren me letërsinë t’onë një pjesëtim sistematik e metodik të kësaj, filluar prej meje gjashtë vjet më parë, kur isha mësonjës i shqipes në Normalen e Elbasanit, e të studjuar e të menduar vazhdimisht, duke e modifikuar e duke e përmirësuar, gjer më sot.¹

Propononja atëherë që i gjithë prodhimi letrar shqiptar nga shekulli XV gjer tek ky i yni, të ndahej në dy grupe të mëdhenj: 1) Prodhim letrar shqiptar përpara Lidhjes së Prizrendit e 2) Prodhim letrar shqiptar pas Lidhjes së Prizrendit.

Grupit të parë si nisje i caktonja gjysmën e shekulli XV duke arritur pothuaj, një pjesë nga fundi XIX shekull, dhe përmblihtja në të, të gjithë aktivitetin kulturor e letrar që u zhvillua në qendra të ndryshme të Shqipërisë së atëhershme, d. m. th. në një Shqipëri që nukë ekzistonte edhe si shtet. Shtonja edhe se ky grupi i parë as që munt të quhej letrar me kuptimin më të kulluar të fjalës:

1 Namik Ressuli, “Gegërishtja a po toskërishtja”, “Shkëndija”, I – 1940, nr.2 , fq. 9 – 18.

a) Pse këto shkrime që përbleth ky grup nukë janë shkruar me nonjë qëllim *estetik a letrar*, po janë pothuaj të gjitha, me përjashtim të një grupi laik, shkrime fetare të punuara nga priftërinj katolikë a orthodoxë me qëllim propagande a mësi të fesë;

b) Pse këto lëvizje, ose më mirë këto lëvizje kulturore përpara Lidhjes së Prizrendit nukë kanë pasur asnjë njësi, as një vazhdimsi, as edhe nonjë përhapje nëpër gjithë Shqiptarët e atëherëshëm. Ato kanë qenë fenomene kulturore, sporadike, krejt krahinore, që lindnë e vdiqën pa lënë më të voglën gjurmë në lëvizjen letrare më të pastajmen, d. m. th. në atë që lindi pas Lidhjes së Prizrendit.

Veç asaj, ky prodhim na paraqitet edhe i përçarë e pa farë lidhjeje. Prodhimi letrar që lindi p.sh. në qendra katolike të veriut nukë ka të bëjë fare me prodhimin letrar që u zhvillua në qendra orthodoxe të jugës e këta të dy nukë kanë aspak nonjë marrëdhënie me prodhimin letrar mysliman. E ndava prandaj edhe këtë grup në tre nënë – grupe të tjerë: 1) Shkrimtarë të vjetër të veriut, a gegë katolikë, 2) Shkrimtarë të vjetër të jugës, a toskë orthodoxë, 3) Shkrimtarë të vjetër myslimanë.

Grupi i dytë, përkundër, përbleth të gjithë prodhimin letrar që nis që nga Shoqëria e Stambollit dhe arrin gjer në ditët t’ona. Prandaj i kemi caktuar si kufi nisiatorei në senin late kuptohet, kësi prodhimi Lidhjen e Prizrendit, e cila qe mema, të thomi kështu, e Shoqërisë së Stambollit. Do me – thënë u vërtetua edhe në Shqipëri ajo që ngjan pothuaj në të gjitha shtetet tjera të Ballkanit: latratyra e tyre filloj bashkë me zgjimin kombëtar.

Për të parën herë, pra, në historinë e tyre Shqiptarët, gjer atëherë të shpërndarë e të përçarë, mbliidhen rreth vatrës së Stambollit dhe punojnë me parime e qëllime të njëjta e të përbashkëta drejtë dritësimit të vendit që i polli. E prandaj për të parën herë letratyra e re, që në fashqe na paraqitet e vetëme dhe e njëjtë, si shprehje e të gjithë Shqipëtarëve pa dallim feje a krahine.

Kaqë thoshja atëherë duke bërë fjalë mi një ndarje sistematike të letratyrës s’onë, ndarje që nukë e propononja për lehtësi teknike a studjimi, po pse vetë faktet e imponojnë; e shtonja se një vënt më vete mbrenda suazës së letratyrës s’onë duhet t’i caktohet edhe prodhimi italo – shqipëtar – prodhim, i cili që nga Lekë a Lukë Matranga, e gjer pothuaj në funt të shekullit të shkuar, u zhvillua krejt pavarësisht prej prodhimit letrar t’onit – mbasi qëllimi a detyra e historisë letrare nukë është të caktojë e të dëftojë vetëm vlerën e çdo shkrimtari të marrë veçmas, po kryesisht të studiojë e të inkuadrojë zhvillimin e tërë një prodhimi letrar, të çdo kohe e të çdo vendi.

Po tani një problem shumë me rëndësi është vënë, ta thomi me një shprehje italishte, “në tavolinë” problemi i gjuhës së përbashkët, problemi që ka dhënë kushtrimin në të gjithë shkrimtarët e studjimtaret – e jo vetëm në këta, të cilët të gjithë pyesin e presin me gojë hapët: “kush do të jetë gjuha zyrtare, a po toskërishtja?”.

Me të vërtetë problemi është i vjetër, aqë i vjetër sa edhe letratyra shqipe vetë, dhe është rrahur prej kohe; po sot me themelimin e *Institutit për studimet shqipëtare* duket se merr një rëndësi të veçantë dhe një trajtë më lëndore. Ja pse

po marr lejen të shkruajë këto rradhë duke thënë mendimet e mia rreth çështjes, dhe ja pse e fillova duke studjuar pikërisht zhvillimin, evolucionin e letratyrës s’onë e jo duke vështruar se si i a arritën kombet tjerë gjuhës së tyre të përbashkët, ashtu siç kanë bërë përgjithësisht shumë nga shkrimtarët t’anë që s’lodhen kurrë të përmendin se qysh u trajtua gjuha zyrtare e këti apo e ati shteti.

E vërteta është se kush nukë njih të tjerët, nukë njih mirë as veten e tij. Studjimi i zhvillimeve gjuhësore të të huajve... e jo vetëm i zhvillimit e evolucionit gjuhësor, po edhe i çdo fushe të veprimtarisë mendore e parktike – bije kontribute të paçmuara në rënimet e studjimet kombëtare, por nga nonjë herë duke i pasur syt gjithënjë larg, përtej kufive t’ona, na godit mjerisht të mos shohim e të mos shquajmë mirë si po ngjan e po zhvillohet përpara e pranë nesh.

Po shumë herë gabimet a mosmarrëveshjet rriedhin sidomos edhe nga një shkak tjetër: nga “*impostimi*” i *keq i problemit*. Në një çështje kaqë delikate e kaqë gjallësore për ne, nukë duhet pyetur pa – një – pa dy a do të pranohet toskërishtja ose gegërishtja si gjuhë e përbashkët, a ka kontribuar më tepër në fushën e letrësisë e para ose e dyta, e sidomos duhet ruajtur nga “pasionet krahinore”, nga “regionalizmi, pse vetë poetët e prozatorët t’anë të mëdhenj, Naimi e Fishta, Konica e Noli, Lasgushi e Koliqi, më parë se të jenë toskë a gegë, janë Shqipëtarë e kësaj Shqipërie ia kanë kushtuar veprimtarinë e tyre mendore, jo fshatit a qytetit ku lindnë. Veç asaj më duket edhe sikur u bëhet një e fyeme këtyre shkrimtarëve, sidomos më të vjetërve, kur hyjmë e përziejme emrat e tyre në çështje krahinore, mbasi ata vetë pikërisht këtë të zezë luftuan: përçarjen e Shqipëtarëve në krahina e krahina. Përkundër, problemi duhet studjuar më shtruarazi , më intësisht duke rrahur e shoshitur çdo mendim që munt të vlejë, pa pasion e pa mëri, dhe sidomos duke filluar më parë studjimin e zhvillimin e evolucionit e gjendjes së tanishme të të dy dialekteve kryesore në sa të përdorur të dy si gjuhë shkrimi, pse kam bindje se vetëm e vetëm duke studjuar thellësisht e imtësisht të shkruarit e çdo dialekti, duke mos i larguar sytë kurrë prej kësaj, munt të thomi gjëkafshë, munt të parashohim me një farë mënyre se si do të jetë e arthëmjja, e kështu mundësisht të marrim masa për ta shpeituar këtë; pse po dihet natura non facit saltus; as do të jemi ne ata që do të bëjmë të kundërtën.

II. – Pamë pak më lartë se prodhimi letrar shqipëtar i grupit të parë është një prodhim sporadik krejt krahinor, lindur e gdukur në qendra katolike, orthodoxe a myslimane të Shqipërisë, pa njësi, pa qëllime të caktuara e sidomos pa pasoja. Vetëm me Shoqërinë e Stambollit nis letratyra e jonë, letratyra e përbashkët, letratyra e të gjithë Shqipëtarëve, e shtetit shqipëtar që s’kish lindur. Do – me thënë ajo letratyrë që dëshironin anëtarët e shoqërisë, ajo letratyrë për të cilën punuan. Dhe me të vërtetë, pas gjashtëdhjetë e ca vjetëve, munt të thomi se themelonjësit e saj ia arritën plotësisht qëllimit. Prej asaj kohe katolikë, orthodoxë, myslimanë nukë shkruan më vetëm për bashkëfetarët e tyre, por për mbarë Shqipërinë, për mbarë Shqipëtarët.

Po a munt të pohojmë, pa të ndrojtur, për këtë prodhim që lulëzoi me hov të mrekullueshëm pas shoqërisë së Stambollit – aqë sa mbrenda një gjysëm shekulli t’i japë Shqipërisë një letratyrë aspak më të ulët se letratyrat e shteteve të tjera ballkanike, bile në shumë pika edhe mjaft më origjinale – a munt të pohojmë, pyes nëse është me të vërtetë aqë i njëjtë, aqë i përbashkët sa duket përcipërisht? Unë kam bindje se jo. Në se në parimet, në se në qëllimet që e frymëzuan dhe e udhëhoqën ky prodhim i dytë qe pa dyshim i njëjtë, *në trajtat, në mendimet, në mentalitetet*, së fundi në tradita nukë qe aspak. Që në fillim studjimtari i duruarshëm do të shohë se edhe kësaj here dy rryma, dy korrente, nisin të vizohen duke u trashur gjithënjë më shumë, me karakteristika e fytyra krejtë të ndryshme njëra prej tjetrës sa do të qe parimisht aspak në kundërshtim. Dhe do të shohë gjith – ashtu se këto dy rryma në vënt që të çdukin njëra tjetrën duke u bashkuar a duke u shkrirë, vazhduan dhe vazhdojnë me ritme të paprerë gjer në ditët t’ona.

Po të donja t’u jepja një farë trajte lëndore këtyre dy rrymave, për ta bërë më të kthiellët idenë, do t’i përfytyronja këto si dy rrota sëhati, të cilat edhe duke u gjendur mbrenda një kapaku e të drejtura që të dyja me një qëllim të vetëm – me shënimin e orëve – lëvizin e shkojnë përpara secila për punë të saj. E unë besonj se asnjë krahasim tjetër më i përshtatshëm munt të na japë një ide të gjallë të zhvillimit t’onë letrar pas Shoqërisë së Stambollit.

Qarku i lëvizjes së rrotës së parë përfshiu pjesën më të madhe të Shqipërisë, që nga krahinat më të largëta të jugës e gjer përtej Fushës Krus. Është pikërisht kjo rrotë që përfaqëson në fillim – pse nisi të lëvizë më parë – kombin shqipëtar pa dallim fisi a feje, d. m. th. të gjithë toskët e gegët që gjendeshin mbrenda qarkut të lëvizjeve të saja, myslimanë e të krishterë. Ajo nisi prej kohëve më të lashta, që po sa u themelua Shoqëria, e siç do të shohim më poshtë, me ritëm më të ngadalshëm, vazhdon edhe sot. Qendrë të vetmë e të caktuar nukë pati. Epiqendrat e saja qenë të ndryshme: më parë Stambolli, pse aty u themelua Shoqëria, pastaj Bukureshti, pastaj nga pakë kudo në të katër anët e botës, Evropë, Afrikë (Egyti), Amerikë. Më vonë, me ndërtimin e Shqipërisë në shtet, stabilizohet në atdhe, pa vënt të caktuar. Është pra, lëvizja e parë e letratyrës s’onë e nisur dhe e përfaqësue me vetëm prej toskësh, toskë janë librat që botohen me qindra, toske janë revistat e fletoret që mbijnë në çdo kënt të



Evropës ku rrojnë dy Shqipëtarë, toskë janë shoqëritë me qëllime kombëtare e kulturore. Në sa njëra pas tjetrës llojë llojë veprash shohin dritën, Naimi, Çajupi, Asdreni, Konica, më vonë Fan Noli, të rrethuar prej një çete të gjerë shkrimtarësh më të vegjël i japin kryeveprat e para letërsisë së themeluar prej tyre. Edhe dialekti, pra që zotron, i pakontestuar në tërë fushën kulturore, është toskërishtja. Gjendemi kështu mbrënda një kohe të shkurtër nga fillimi në kulmin e toskërishtes e unë besoj se po mos të kishin qenë priftërinjt e fetërit katolikë, po mos të kish nisur të lëvizte edhe rrota e dytë, ne s'do të kishim sot asnjë libër me vlerë në gegërishtet dhe toskërishtja, me njësimin e Shqipërisë, me zgjerimin e komunikatave, ma hapjen e shkollave do të kish arritur sot e kësaj dite gjer në bjeshkët e Malcisë, duke u zbërthyer me të edhe problemi i gjuhës së përbashkët.

Po shpejt “rrota” e dytë hyn në veprim.

Qarku i lëvizjeve të kësaj “rrote”, shumë më i vogël nga i pari, nukë del përtej kufive të Shkodrës e munt të thirret një qark kulturor krejt shkodran katolik. E frymëzuar edhe “këjo rrotë” nga të njëjtat ndjenja, parime e qëllime që shtytën të parën duke kontribuar nga an’ e saj në mënyrë të mrekulluarshme për pasurimin e letraturës shqipe, prapë se prapë, në fillim mbeti një gjë lokale si e ndarë nga pjesa tjetër e Shqipërisë dhe i nis më vonë lëvizjet e saja. Arësytet e kësaj ndarjeje, e këti dallimi rrënjësor që edhe sot vihet re në mes të shkrimtarëve toskë e shkodranë, duhen kërkuar 1) në feja dhe 2) në tradita kulturore.

1) Në feja pse kultura në Shkodër qe gjithënjë në duar të priftërinjve e të fetërve katolikë, të cilët sipas gjurmave të Buzukut, Budit, Bogdanit me shokë, ruajtën të pashojtur, për katër shekuj me radhë në mes të tallazeve të detit të pafurishëm turk, ndjenjën e kombësisë e të qytetërimit perëndimor. Prandaj, në sa lëvizja letrare e Shoqërisë së Stambollit lindëte ex novo, pa vazhduar asnjë nga rrymat letrare më të përparëshme që u çfaqën në Toskëri, d. m. th. as prodhimin letrar toskë – orthodox as atë mysliman, në Shkodër prodhimi letrar i quajtur gegë katolikë, edhe pas themelimit të Shoqërisë së Stambollit, vazhdoi akoma për disa kohë duke formuar atë që është thirrur “letraturë agjogardie, me karakter siç e thotë vetë emëri, natyrisht fetar e kështu e kulturor vetëm në besimtarët katolikë. Mjafton t'i hedhim sytë një bibliografie të plotë për të vërejtur se në sa në Stamboll, në Bukuresht, në Sofie, në Egypt etj., shtypen libra profane me ngjyrë krejtë laike, në Shkodër qarkullojnë vetëm vepra fetare, bile të shtypura me alfabetin e vjetër të shkrimtarëve gegë katolikë. Vërtetë, këtu këtë shohim botimin e nonjë libri të vogël mësimi si abetare “kunoitore” etj.: po këto libra nuk dualën kurrë jashtë Shkodrës, edhe pse çdo gjë që delte nga muret e kuvendeve katolike nukë interesonte nato kohë myslimanët e orthodoxët e anasjelltas. Me një fjalë, këtej nga ana e Shqipërisë së mesme e së jugës hovi i kulturës është laik, andej nga ana e Shkodrës klerikal, fetar: këtu mos interesimi i të dy palëve. Duhet shtuar pastaj se nga mungesa e komunikatave, nga mungesa e një shteti, e një qeverie, Shkodra mbeste si e vetmuar nga pjesa tjetër e Shqipërisë.

Po me rasjen më të parë, po sa nisin të marrin pak frymë, shkrimtarët e poetët laikë të Shkodrës lindi për mrekulli, bash nga muret e atyre kishave e kuvendeve, që do të linin një emër të pavdekur në fushën e letrësisë shqiptare: po prap se prap kultura në Shkodër mbeti ekskluzivisht katolike, mbassi myslimanët flinin edhe në gjumin e shekujve.

2) Në traditat kulturore: pse të gjithë priftërinjtë, e pra

shkrimtarët e poetët, dilnin nga seminaret e shkollat e Evropës të pajosur me kulturë klasike thjeshtë latine. Trashëgonin kështu edhe ata atë kulturë tradicionale të Perëndimit në kundërshtim me pseudokulturën e Orientit të afërm. Gjurma të kësaj kulture, të kësaj tradite, të këti mentaliteti që dalë nga dalë duke dalë jashtë mureve të kuvendeve do të konsolidohej në Shkodër, i gjejmë në çdo faqe, në çdo radhë të shkrimtarëve gegë shkodranë nga më të mëdhenjt gjer tek më të vegjëlit, si edhe ndër ata që nukë pretendojnë të jenë të tillë. Kurse zhvillimi kulturor i pjesës tjetër të Shqipërisë nukë pati *as një kulturë të njëjtë as një kulturë të vërtetë* si trashëgim. Naimi me shokë vijnë nga shkolla të ndryshme, nga shkolla që ato vetë nukë kishin një kulturë të vërtetë a të njëjtë. Aty edhe shkollat e Greqisë – djepi i klasicizmit në të kaluar – krejtë kulturë klasike nukë kishin. Dhe jo që shkrimtarët e parë toskë i kanë pasur gjithënjë sytë nga Perëndimi, kulturën e këti nukë e asimiluan dot kurrë, pse iu mungonte ambienti, iu mungonte baza. Krahasoni p.sh. Naimin me Fishtë, ose Çajupin e Asdrenin me Mjedën ose Prendushin e do ta shihni menjëherë këtë dallim: tjetër stil, tjetër mendim, tjetër mentalitet, tjetër teknikë, tjera orizonte në mes të tyre. Në gegët zotron retorika – retorika në kuptimin më të mirë e më të dobishëm të fjalës: shënjë e studjimeve të rregullta e të shëndosha – mitologjia, piekuria e përsosuria e stilit e i vargjeve, me një fjalë vlon në shkrimet e tyre si “flad umanismi” që e vërejmë në klasikët e në kulturën italiane. Nga pikëpamja teknike gjithashtu gjejmë në ta ndryshime e pasuri metrash në përpilimin e vargjeve. Në toskë, ndoshta më tepër “spontanitet”, më tepër thjeshtësi e freshkësi, më tepër origjinalitet në sa frymëzohen nga letratyrja gojore e popullit – cilësi që retorika i ka mbytur në shkrimtarët shkodranë, pa përcipëri mendimesh, një farë disorientimi kulturor, mungesë kujdesi në stil e në “vargënim”. Aty edhe sot e kësaj dite ky dallim diskutohet në poetët toskë e gegë e provë e gjallë janë, mi të gjithë tjerët, dy përqafqësonjësit më të rinj e më të denjëshëm të të dyja shkollave: Koliqi e Lasgushi, sa do që ky i funtmi ngrihet lartë mbi të gjithë poetët tjerë që ka pasur Toskëria.

Ky ndryshim kulturor pra e, së dyti, ndryshimi fetar qenë shkaqet që lëvizja letrare shkodrane, sado e shëndoshë dhe e mirë – përgatitur, në i kaloi kufitë me poetët e saj më të mëdhenj, me Fishtë, me Mjedën, me Prendushin, nukë i përhapi dot rrymat, drejtimet, mentalitetin e saj në pjesën tjetër të Shqipërisë. Zotrohej kështu e tërë kjo pjesa tjetër e Shqipërisë nga lëvizja kulturore toske. Po gegërishtja me lëvizjen shkodrane nxirrte kryet në letratyrën shqipe për gjithënjë dhe përforconte definitivisht cakun e saj.

E kështu siç na paraqitet i përçarë grupi i parë i prodhimit letrar shqipëtar në traditë e në formë i përçarë në dy rryma na paraqitet edhe prodhimi i dytë e dy dialektet nisin këtej e tutje të maten në mes të tyre, duke zotnuar ma tepër dialekti toskë, pse los rolin në pjesën më të madhe të vendit.

III. - Po me krijimin e Shqipërisë në shtet e sidomos me ngritjen e Tiranës në kryeqytet, puna fillon të ndryshojë për toskërishten.

Zgjedhja e një qyteti të Gegërisë pati një rëndësi të veçantë e vazhdon të ketë gjithënjë më tepër për trajtimin e gjuhës së përbashkët dhe posaçërisht për predominimin e njërit nga të dy dialektet kryesorë.

• Vërtetë më parë gegërishtja e Shkodrës nukë e influencoi toskërishten, as kjo atë: shkrimtarët toskë dhe gegë vazhduan të shkruajnë në dialektet e tyre: po një fakt i ri nis të vërtetohet me

ardhjen e kryeqytetit në Gegëri: nis të përhapet nër nëpunësit, nër zyrat, nër shkollat, nër nxënësit, nër mësonjësit d.m.th. në qarqet e mesëme intelektuale, duke zbritur dalë nga dalë edhe në klasët më të ulët, p. sh. nër ushtarët – nër ata qarqe që shpesh lozin një rol më të math se ai i poetëve dhe i prozatorëve të mëdhenj në një vent me shumicë analfabetësh, ku zëri i poetit të math nukë arrin – dialekti i Gegërisë së mesëme, pikërisht ai dialekt që s'ka kontribuar aspakë në fushën e letrësisë, ai dialekt që s'ka pasur jo një Dante(!) po as një Çajup, a një Asdren a një Prendush, dhe që vetëm me një Kristoforidh munt të mburret – sado që po të merren veprat e tia, pamvarësisht nga njeriu, munt të thomi për të se qe aqë gegë sa edhe toskë, pse i dituri elbasanas i përdori të dy dialektet) - e tani vonë vetëm një Haxhiadem munt të përmendë.

Ky fakt, ky fenomen i ri që u vërtetua me krijimin e shtetit shqipëtar më duket se ka një rëndësi bazë për të paraparë t'arthëmen e gjuhës së përbashkët, e prandaj duhet studjuar në të gjitha çfaqet e tia më të imëta.

Shkaqet që e shkaktuan munt të përmbledhen:

1) Siç thamë më lart, *ngritja e Tiranës në kryeqytet*. Prej asaj kohe sytë e të gjithë Shqipëtarëve, toskë e gegë, janë drejtuar nga Tirana: në Tiranë vijnë ata për nevojat e tyre shtetrorë e private; në Tiranë është mbedhur ajka e intelektualëve shqipëtarë, pa dallim krahine a feje; në Tiranë përdridhet politika e vendit e vendosen fatet; në Tiranë, me një fjalë, ka qendrën krei, trutë e atdheut e me gjithë që në vetvete Tirana si qytet i thjeshtë moralisht nukë los as më të voglin rol, pse në shkallë kulturore mjaftë të ulët, e me gjithë që revistat e gazetatat më të mira të kryeqytetit kanë qënë në duar të toskëve e kanë nusëruar penda me vlerë në fushën e gazetarisë, si atë të Vangjel Koçës, të Nebil Çilrës e të Timo Dilos, prapë se prapë intluksi i dialektit gegë – sa do i lehtë hë për hë – është ndjerë dhe ka për t'u ndjerë gjithënjë më tepër.

a) *Normalja e Elbasanit*. Pse më e mira shkollë normale e Shqipërisë e pati dhe e ka qendrën në një qytet gegë. Djemët, më shumë edhe tashë, toskë duke ardhur në Elbasan në një moshë të njomë, në të cilën instiktivisht dialektet dhe gjuhët e huaja njësohen më lehtë, nisin edhe ata të flasin, a në mos tjetër, të shkruajnë gegërisht, gjë që e kam vërejtur vetë si mësonjësi i shqipes në këtë shkollë. E natyrisht, pasi mbarojnë studjimet këta djemtë në shkollat fillore ku dërgohen, bëhen përhapësa të këti dialekti e jo te toskërishtes. Po rolin më të math nukë e lozi aqë fort vetvetiu Normalia e Elbasanit se sa një nga drejtorët e saj, Aleksandër Xhuvani. Fati deshi që në krye të këti Instituti të gjendej herë pas here e me periudha të gjata përfaqësonjësi më i mirë i Shqipërisë së mesëme, pas Kristoforidhit, i cili siç dihet qëllon edhe lëronjës i gjuhës shqipe. Si “gjuhëtar”, pra Xhuvani e si njohës i thellë i shqipes e si përkrahës i dialektit të Elbasanit, i influencoi edhe më tepër djemët me doktrinën e tij, duke qënë ai në ato kohë studjimtari i gjuhës më metodik e më i njohur në krahinat e Shqipërisë së mesëme dhe të jugës. Gjurma të mëdha të influksit gegë lanë librat e tia, gramatika, sintaksa, pedagogjikja etj., që qenë pikërisht librat e gjuhës shqipe të shkruara si pas dialektit të Elbasanit. Edhe sot po dihet, në të gjitha shkollat, nga filloret në të mesëmet, nxënësit po me librat e Xhuvanit e mësojnë gramatikën e sintaksën.

3) *Ministria e Arësimit*. Pse edhe këjo, nga pikëpamja e drejtimit kulturor ka qenë në duarët e Xhuvanit e prandaj ka anuar gjithënjë për dialektin e Shqipërisë së mesëme; e këtu e qit kryet



Namik Ressuli, Lec Shllaku, Isa Ndreu, Ernest Koliqi.

edhe Karl Gurakuqi. Shumica e librave, gjithashtu, të shtypura prej saj a me lejen e saj janë gegërisht.

4) *Në zyrat përdoret si gjuhë zyrtare gegërishtja.* Vetë qeveria me një qarkore – më duket se e vitit 1922 – e imponoj këtë dialekt si gjuhën e saj. Vërtetë nëpunësit toskë të mësuar vazhduan të përdornin toskërishten, po të tjerët adaptuan gegërishten, edhe pse gegërishtja përpara syve të tyre kishte një farë tërheqje, një farë “prestixhi” po atë tërheqje që los edhe në ushtarin toskë, i cili kur kthehet në fshatin e tij e ka si punë të madhe t’u flasë bashkëfshatarëve gegërisht.

5) *Inflluksi i shkrimtarëve të Shkodrës.* Naimi me shokë nukë i kuptuan dot kurrë kufitë e këti qyteti, as nukë u bënë popullorë, pse populli vetë i Shkodrës, i shtytur nga një farë krenarie tradicionale, e vëren me përbuzje e mosbesim çdo gjë që s’ka lindur në qytetin e tij. Po Fishta u admirua, u çmua e u këndua nga të gjithë toskët, e emëri i tij pati një prestixh të math ndër këta, edhe pse vetë karakteri i toskës, më i hapët e më i epët, është gjithënjë gati gati të presë me krahë hapur e të përqafojë çdo gjë që vjen nga jashtë.

6) *Lërimi më i thellë e më sistematik i gegërishtes, sidomos nga pikëpamja e fjalorit.* S’ka dyshim se gegërishtja, me anën e priftërinjve katolikë është punuar e begatuar metodikisht e sistematikisht nga këjo pikëpamje shumë më tepër se toskërishtja, aqë sa dhe vetë toskët janë të detyruar hera herës të marrin hua fjalë nga gegërishtja, jo pse dialekti i tyre nukë i ka, po pse asnjë prej tyre nukë ka punuar shkencërisht në këtë fushë, d.m.th. se asnjë prej tyre nukë ka pasur durimin “çertosin” të priftërinjve e të fretërve katolikë. Gjithashtu shumica e fjalëve të ra janë trajtuar e po trajtohen sipas shpirtit të gegërishtes.

7) *Po dialektin e mesëm e bëri më të fortë puna se, në njëfarë mënyre, ky dialekt u gjent i njëjtë me dialektin e shkrimtarëve të Shkodrës, ose të paktën u gjent shumë më afër këti se sa toskërishtes, e kështu e përvetësjo prodhimin letrar shkodran duke e konsideruar si të tijën.* E qe pikërisht afrimi i dy dialekteve e “prestixhi” i këtyre shkrimtarëve që magjepsi edhe nxënësit, mësonjësit e nëpunësit toskë, d.m.th. të gjithë ata, të cilët të zënë në punë siç janë, nukë kanë kohë të thellësohen në probleme gjuhësore a t’i rrahin më gjatë.

Këto fakte, pra, duke e studjuar çështjen vetëm historikisht na shtrëngojnë të thomi se shënohet një “soprafacion” i gegërishtes kundrejtë toskërishtes, jo në shkrimtarët toskë, po në klasët intelektuale të mesëme e të ulëta, geqe e toske. Këtyre fakteve duhet shtuar pastaj edhe fakti se disa shkrimtarë të Shqipërisë se veriut, të paktën ata që nukë shkruajnë vetëm në revista shkodrane, preferojnë gegërishten e mesëme mbi të gjithë këta për t’u shënuar kontributi konkret i Koliqit.

Po në favor të gegërishtes së mesëme do të veprojnë edhe dy faktorë të rinj: a) se në krye të Institutit për studimet shqipëtare gjendet një gegë. Z. Mustafa Kruja i cili siç dihet anon për dialektin e mesëm dhe ka gati për shtyp një fjalor: më i madhi e më i pasuri siç na thonë, që është gjer më sot; b) pse trajtat tepër të ashpërta e të vrazhdëta të gegërishtes së veriut dhe ato tepër “të qullëta” të toskërishtes së jugës vijnë e pastrohen e ëmbëlsohen në ujërat e Shkumbinit.

Kështu dialekti që kontribuoj më pakë e aspakë në fushën e letrësisë s’onë, nga sa dëftym, duket se ka më tepër mundësi të ngrihet në dinjitetin e gjuhës kombëtare edhe pa dekrete e qarkore qeveritare, pra në historinë e gjuhës shqipe rolin kryesor nukë po e los më poeti i math, mbassi fati deshi që të dy palët, edhe toskët edhe gegët, të kenë poetë e prozatorë të mëdhenj të cilët neutralizojnë njëri tjetrin – dhe asnjëri prej tyre s’ka mundur të ngrihet me fluturimin e shqiponjës më lartë tjerëve – as klasat e larta intelektuale po kolektiviteti, shteti vetë. Pse me lindjen e shtetit përpara gjuhës së përbashkët kjo bëhet një konditë e domosdoshme për të parin, e pra edhe çështja e gjuhës bëhet një çështje jo vetëm “letrare” po edhe “shtetrorë”.

Nga sa thamë, pra, në këto faqe munt të nxjerrim këto përfundime kryesore letrare e gjuhësore:

- 1) Se jo vetëm prodhimi letrar i grupit të parë na paraqitet i përçarë , po nga pikëpamja e trajtës edhe ai i grupit të dytë.
- 2) Kontributi i pabiseduarshëm i toskëve në letrësinë shqipëtare.
- 3) Se gjuha e përbashkët e arthëme si pas zhvillimit e evolucionit historik të saj gjer më sot – veç se në mos u vërtetofshin shkaqe të ra që t’i këmbëjnë drejtimin që ka marrë – shkon drejtë dialektit të Shqipërisë së mesëme.

Po Dante-n, Dante-n e krahasonin me trajtimin e gjuhëve të tjera ku na i le? – jamë i sigurt se do të më pyesë nonjë nga lëçitësit e mi. E këtu le të më lejohet të thomë se krahasimi me Danten dhe me trajtimin e gjuhës së tij nga një anë dhe të shqipes nga ana tjetër, sado që ka mjaftë pika takimi, nukë është krejt më vënt, pse zhvillimi historik i të dy gjuhëve është pothua i kundërt për dy arsye: a) pse ne, mjerisht nuk jemi një Dante; b) pse gjuha e përbashkët italishte u lint më parë se të formohej Italia si shtet; bile qe ky një nga shkaqet që e vonoi konsolidimin e gjuhës së përbashkët në Itali.

Ne jemi përkundër, një shtet pa gjuhë që shkojmë duke kërkuar një Dante.

A duhet të presim, vallë gjer sa të na vijë?

Për një pjesëtim ma të drejtë të letratyres s’onë!

Nga Filip Fishta

Lexoj në „Shkëndija“ një artikull, kisha me thanë të rendit të ditës, shkruie nga prof. Namik Ressuli. Le të më lejohet të marr pjesë në këtë radhë jo në kësi bisedimi të gjatë të problemit të gjuhës së shkrimit, por rreth ndo’i pike tjetër të a’tij artikulli. Qëllimi i im asht të qes në një rrugë ma të natyrshme e ma të drejtë një pohim të gabueshëm qi e ndëgjoj tash sa kohë jo prej një veltjeje së vetme. Prof. Ressuli a një profesuer tjetër, nuk e di se cili i pari, thotë se letratyren t’onë duhet ta ndajmë në dy grupe të mdha:¹

- a. Para Lidhjes së Prirendit
- b. mbas Lidhjes së Prirendit.

Deri këtu s’kishja me pasë gja kundra, me gjithse këtij pjesëtimi në vazhim të të mësimi të kësaj lande prej vjetit 1934 e tekndej nuk i kam ndejë. Kam ba pjesëtime tjera, mbas mendimi t’im ma të caktueshme për letratyren t’onë, të cilat po i përmbledhi në këtë rasë para se të shtrohemi në tyezën e një bisedimi akademik. Pjesëtimet e mia vazhdojnë të jenë këto:

- 1-Monumenta e shkrimtarë të vjetër, (prej të 15 qindvjet e deri në gjysmën e qindvjetit 17 – vjeti 1743)
- 2-Shkrimtarët e parë Arbëneshë apo Italo-Shqiptarë (Qe e pa mundun paraqitja e veprimit letrar të kolonivet Italo-Shqiptare në një pjesë të veçantë, mbasi shkrimtarët e tyne xanë vend përgjithsisht ndër te tanë qindvjett e lindjes e të yhvillimit të letratyres s’onë).
- 3-Zhvillimi i letratyres asketiko – liturgjike e hagiografike (prej gjysmës së të 17 qindvjet, deri me të 19-tin qindvjet).
- 4-Jehu u romantizmi (i 19-tti qindvjet i Hjeronym de Radës).
- 5-Letratyra popullore.
- 6-Prirje të ndryshme letrare (letratyra e re).

T’i rrijmë pjesëtimin të Prof. Ressulit tue u ndalë mbi dy pika: Aj i mohon grupit të parë (para Lidhjes së Prizrendit) disa veti: a-pse këto shkrime që përmbledh ky grup nukë janë shkruar me nonjë qëllim estetik a letrar, b- pse lindnë e vdiqën pa lënë më të voglën gjurmë në lëvizjen letrare më të pastajme, d.m.th në atë që lindi pas Lidhjes së Prizrendit.

Po nisi së pari me at pjesën ma origjinale e ma të zgjedhunën, me prodhimin e letratyres popullore shqipe, qi asht pjesë përbase e pashkëputun nga letratyra e jonë përgjithsisht. Ajo asht sigurisht e kohës – para Lidhjes së Prizrendit – aj kufi i caktuem gabimisht për vepra shqipe të cilat nuk i plotsuekan kushtet e esthetikës e të letratyres komtare. Mbi vjetërsin e disavet prej këtyne kangëve asht e kotë të bisedoj haptas këtu. Po bij vetëm një provë, mbas mendimit t’im të mjaftueshme në këtë rasë. Mund t’a provojmë HISTORIKISHT se b.fj. kangët popullore shqipe me përmbajtje historike, sikur ato mbi Skandërbeun, këndoheshin „da tutti gli Albanesi“ qysh në kohën e atij përshkrimi të gjatë të vizitës baritore të kryeipeshkvit të Tivarit Marin Bizzi-t, e vazhdueshme nëpër Shqipni, mbrenda e jashta kufijve të soçëm politikë. Një dokument i Marin Bizzi-t, sot në Vatikan, shkruen edhe mbi kangët t’ona popullore të përmenduna parandej, i përket vjetit 1610.

Vi ke pjesa tjetër e bisedimit të hapët me Prof. Ressulin, se deri ku asht e vërtetë – mbas asaj prove së parë qi dhaçë, se prodhimi i letratyres s’onë, i atyne prirejvet esthetike e letrare qi e ban të jetojë ende e të bahet pikë pështetjeje e së drejtës s’onë, ka lulzue edhe PERPARA Lidhjes së Prizrendit e, për një koençidendë të çuditëshme të këtij emni historik, pjesërisht po nàto vise, sot larg Shqipnije.

Due t’i marr shkrimtarët Shqiptarë si mbas rendit e kohës, tue mos ba vetëm një numrim të that’ t’atyne emnave e të shkrimtarëve t’onë të vjetër, të cilët nuk do të më hyjnë në punë në mbrojtjen e thezës s’ime. Unë qi i due e i kam aq për zemër ato drita të shkëlqyeshme të ruejtjes së gjuhës, të letrarëve t’ona të vjetër, të cilët bajnë provët e para të pltosojnë, si mbas rrethanave të kohës, të gjitha kushtet e esthetikës e të letratyres, nënvizue prej prof. Ressulit, nuk mundem t’i kaloj në heshtje edhe për arsye të njëj prove së tretë, qi prof. Roques-u në „Recherches sur les anciens textes albanias“ bjen veçanërisht për Budin ndër rreshtat e parë të faqes 31 t’atij libri të çmueshëm. Po e shtyj prof. Ressulin t’i lexojë ata rreshta përsëri. Prof. Roques-u, të cilin kam pasë fatin e bardhë me e pasë mësues t’im, ky mik i vendit t’onë, nàta rreshta pohon një të vërtetë qi edhe nàto kohë të largëta na e ruen të drejtën e qënëjes s’onë si komb, sot bashkue me fatet e Italis e nën hijen e një perandorije e të një Mbreti të madh. Po njëky Budi; për t’a nisun me të së pari, në Pasqyrën e vet (të vj. 1621) qi asht një visar i vërtetë gjuhe, vepron e shkruen shqip, si ma mirë ka

1 Filip Fishta, “Për një pjesëtim ma të drejtë të letratyres s’onë”, “Shkëndija”, I – 1940, nr. 3, fq. 12 – 16.



dijtë, ushtrohet në vjershësin shqipe apo, t’i marr uha shprehjen vjershës së bukur të Fishtës për Budin e letrat e të shkruemet e tija: „...mbas t’cillvet fjalën shkon tue lmue shqyptare“ edhe penda e Budit krijon b.fj. faqën 4 rreshta 4-22 të Pasqyrës, një lutje aq të bukur e aq letrare, dalun prej zemrës së tij në një hov dëshpërimi, mbassi nàta të parë e kishin pasë pritë aq ftohtas dishirin e çfaqun prej tij, mallin e shtampës, si e titulloi Koliqi artikullin e „Shkëndis“, dishirin e botimit të shkrimevet shqipe „me të cilat i kishte ma shurdhuom“ përkrahësit e botimeve shqipe (si na thotë vetë Budi në parathënjën e librit të vet). Vepra e tij nuk ndalet aty. Budi lëmon në një prozë të bukur të Ritualit (të vj. 1621) disa mendime shqipe, disa udhëzime sa të bukura aq tërëhjekëse të njëj procesjoni, me sa stolisje ky mund të bahet. Nuk mund të quhet me ato mungesa të theksueme prej prof. Ressulit vepra apoletike e njëj burri të Kosovës Pjetër Bogdanit: „Çeta e Profetënvët“ qi ka nisë të ribotohet në Shkodër, si edhe ndonji vjershë këndue bje fjala prej Lukë Bogdanit për nderim të tij nàt libër të vjetit 1685: „Bogdan, lavdi të qendrofët, - Sa breshka rruzullimin! “! Edhe deri diku vepra shqipe: „Kuvendi i Arbënit 1703“, botue në 1706 në Romë, na ep një nga provë të para, nëpër botimin e fjalës së V. Zmajevichit, të njëj fjalimi të rrjedhëshëm e të kumbueshëm. A nuk duhet kurrsesi t’a përfshijmë në grumbullin e letratyres shqipe PARA Prizrendit të gjith veprën e zgjedhun të Shqiptarëvet në jug t’Italis? Prof. Marchiano-i, Gualtieri, Skiroi e ndër të soçëmt prof. Petrotta, na i kan qitë në shesh edhe këto prodhime letrare t’Italo – Shqiptarëvet nga një herë të zgjedhuna, tue nisë prej N. Figlia-s e Brancato-s e tue ardhë deri ke vepra letrare prirjesh apo fryme shqiptare e një De Radës, i cili deri në kohën e Lidhjes së Prizrendit e ka pasë mbyllë një pjesë të randësishme të veprimit të vet letrar e kombtar. Botimi i parë i Milosaut, komentue ma vonë nga prof. Ressuli, asht i vjetit 1836.

Vepra e Pjetër Zarishtit e vjetit 1837, një jetëshkrim të të cilit edhe një koment kritik të disa vjershavë të tija po i dorëzoi me qëllim botimi „Shëkndis“, kjo vepër e Zarishtit, përmbi të cilin nisi me u shkruie qyshë në 1872 në Tireshtë (Dora d’Istria, Zef Jubani) në Venedik në 1881 (De Martino) në Napull në 1918 (Zef Skiroi) e në Shkodër në 1914 (Hylli i Dritës) na ven në dijeni të njëj letrari Shqiptar, i cili merret edhe me subjekte të kohës, stolisja e çdo letratyre botnore. Këtu Manzoni me Hymnet e veta kujtoj se e ka vendin, mbassi në 1880, në një gëgnishte krejt letrare asht përkthye hymni i Manzoniz „Këshnellat“, shtypë prej De Martinit te vepra „Arpa“. Zarishti, përveç ndonji subjekti fetar, vebet të këndojë tjera vargje shqipe. Këndon për nderimin e Derës së Gjo Markut, tue na dhanë ma të parat tingllime të gjuhës shqipe. Këndon prap në disa tubëza tetë-rrokëshe ket Derë të vjetër Shqiptare, nisë me vargun „Nji Derë paska gjith Arbnija“. Zarishti në 1837 këndon kangën e bylbylit ndër tetë – rrokësha, nisë me vargun „Me t’kuej dorë bylbyli kndueka“ tue u ba prekusori i De Martinit e i Ndre Mjedës mbi ket landë.

Edhe De Martini, vepra e të cilit asht krejt në dialektin gegë, boton kangën e T. Grossit: vaji i hapses, përcjellë me shënimin: Lieve simbolo del lamento dell’Albania, shtypë në Trieshtë në 1868 e rishtypë ke vepra e madhe që botoi në Venedik në 1881: L’Arpa d’un Italo – Albanese. A nuk shtjellonte De Martini, përveç subjektavet fetarë edhe ndonji kangë humoristike, kjo kangë aq e gjallë e tërëhjekëse, qujtë prej auktorit me një fjalë tyrqishte „llafexhore“, mirret edhe me zakonet e mikpritjes shqiptare, hartue sikur mund të shifet PARA Lidhjes së Prizrendit.

Po ket prodhim letrar, në kuptimin ma të ngushtin e tijin e kemi, gjithnji po e theksoj, para Lidhjes së Prizrendit, po prej ndonji shkrimtari të Kosovës shqiptare, b.fj, prej Ndue Bytyqit e Pashko Bushit, vepra e të cilvet pjesërisht patën qenë shtypun në Elçin, në Lajmëtarin e mavonshëm e në kalendarin e Veprës Piore, vjersha në shumicë mbetë ne dorëshkrim. Me vargjet e Ndue Bytyqit, të shkrueme në Pejë në 1874 – para Lidhjes së Prizrendit e në vargjet e De Martinit po t’atij vjeti, vëm re një gjuhë, njëmend të trazue me elementa të gjuhës tyrqishte, - shprehje e kohës: - por vrejme njëj heri edhe njëj vazhdim të trashigimit letrar para Lidhjes së Prizrendit.

Libri me tregime i Eqrem Bashës, "Hije në grila"

HANI I UDHËTARËVE PLANETARË

Nga Ali Aliu



Poet, tregimtar, romancier, eseist, autor skenarësh për film e TV, njohës i gjuhës dhe i letërsisë frënge, nga e cila përktheu dhjetëra drama, klasike e moderne, romane, ese...; që nga fillimet i ushtron paralelisht poezinë dhe prozën; realiteti që e përfshin brenda tre llojeve letrare është konsistent dhe unik, në përmbajtje, në kohë, në hapësirë; ndjesia, perceptimi, artikuli artistik i botës përreth është veçantia e parë e krijimtarisë letrare të Bashës; ritmi i botimeve i maturuar, - çdo 2-3 vjet me nga një libër, pa bujë, pa paralajmërime e paslajmërime; konstant si në jetë, si në letërsi, si në format dhe veshjet narrative, që nga botimet e para në poezi dhe tregime, këtu e 50 e më shumë vite; artin e vet e sjell me gjuhë plotësisht dalluese, në kuptim të drejtpërdrejtë të fjalës, të veçantë në letërsinë bashkëkohore të shqipes; groteskore, përqeshëse (qesh e ngjesh...), me tis të hollë, elegant absurdi; me optikë narrative të përthyer, të zhvendosur të botës, të përditshmërisë konkrete, gjithë nuancime të holla, estetikisht perfekte; gjithë duke ia lënë të hapur dritaren lexuesit që optikën zhvendosëse narrative ta kthejë në kënd real dhe ta shohë si në dritë të diellit hapësirën ku lëvizin personazhet, botën tonë përreth, të përditshmen, sidomos atë, pjesën e kontaminuar, agresiven dhe depresiven...

Gjithë në këtë rrafsh, skrupuloziteti mimetik i Bashës, qoftë i mbështetur në traditën narrative, poetikën lirike romanore dhe tregimtare dhe trendeve të saj; besueshmëri perfekte mes faktit dhe trillit, mes të thënës dhe të fshehurës, mes shtesës dhe shkurtesës, mes vënies dhe fshirjes së thojzave – e kisha me shaka dhe seriozisht, mes buzëqeshjeve ironike dhe refleksit brengosës, detajeve dhe tërësisë...

+9Çfarësia që e rrethon autorin ndërsa, përditshmëria e trazuar, ajo më acaruesja përballë, ka vlerat e lënduara, jo rrallë të kthyer kokëposhtë; shkelja pa skrupull e

tyre nga një etje për pushtet – (etja për pushtet është më shqetësuesja, më e liga etje e njerëzimit...), që nga derivojnë etjet e tjera, - pushteti i lekut, pushteti i postit, pushteti i shthurjes së moralit dhe deri te agresiviteti, brutaliteti, injoranca, dhuna, kriminaliteti...; aq sheshit dhe të ushtruara thuaja publikisht në hapësirën tonë ballkanike... Këtë ngarkesë bartin në strajcat e tyre personazhet e shumë të Bashës, që në fillimet krijuese të tij, gjithë me substancë të pasuruar edhe në tregimet e librit që kemi përpara; i gjen, tërë spektrin shtresor të njerëzve, që nga rruga, kafeneja, zyra, sheshi, tregu e kudo shfaqen personazhet që, me veshje, sjellje, gjuhë, e begatojnë prozën me rrëfim fare të veçantë, rrëfim që e identifikon autorin që në pasusin e parë të tregimit...; me përjashtim vetëm të një tregimi, ai që qëndron më vete, përjashta katër cikleve me nga katër tregime të vëllimit *Hije në grila*, me titull *Vetëm një natë*, e që mua vazhdimisht më tingëllon si Hani, tregim për hanin....

Tek 15 tregimet e vëllimit *Hije në grila* hasim situata, personazhe, bëma të pangjashme dhe që gjithandej kanë veshje nuancash të holla, sa të absurdit, sa neurotike ditore, sa komike deri përtej kufirit, në prag grotesk, sa dëshpëruese e dramatike, sa agresive e tjetërsuese, derdhur në një shtrat unik, rrëfim të identifikueshëm qartë të Bashës; sipas një kodi narrativ zhvendosës, së jashtmi, sipas një optike që rrëfimin, imazhin, detajin, sjelljen e personazhit të zhvendosur perspektivash të shumëfishta, të lëvizshme, rrëshqitëse thuaja përmbysëse; te të gjitha zhvendosjet autori u lë një shteg të lehtë lexuesve, për t'i sjellë ato në normalitet, - përmes buzëqeshjeve fiktive, diskrete, apo të pashfaqura qartësisht; të gjitha këto shenja dalluese, spektër nuancash të kësaj poetike narrative, mund t'u shkojë si mbulesë e mundshme kodi grotesk; edhe situatat më përsmadhuese si shfaqje, si imazh i kësaj optike narrative dhe sipas këtij kodi narrativ,

autori artikulon rrëfim me nëntekst që penetron thellësisë të gjenezës, të rrënjëve, të botës, të realitetit të përmbysur, të prapë; këtë ngarkesë bartin personazhet, këto dromca refuzimi të prapësive përreth, këtë shqetësim, acarim të fshehur pas veshjes gjysmë loje e gjysmë prej vërteti, gjysmë argëtimi e gjysmë dëshpërimi, indiferentizmi dhe gjysmë këmbënguljeje për të nxjerrë sheshit ligësinë, për ta anatemuar të shëmtuarën në hapësirën tonë, në qenien tonë; këtë ngarkesë kanë, me përjashtim të tregimit *Vetëm një natë*, siç e përmenda edhe më sipër...

Është një natë dhe që shtrihet pafund, epokë; është një njeri që vjen dhe ikën brenda një universi njerëzor; është një han, një strehë sa për një dremkë nga udhëtimi planetar dhe për të vazhduar tutje; pa zë, pa rrëfim, pa lënë gjurmë, as emër, as moshë, as nga, as ku – strehë udhëtimesh universeve; janë udhëtarë që i zë stuhia natën dhe shfaqen te porta e hanit si të ardhur visesh mitike dhe hanxhiu, me fener të ngritur, sa për t'i treguar shkallët mysafirit, hapësirën ndriçuar nga një kërcu që digjet në oxhak, pranë të cilit, në një krah, fle thellë një planetar si ky, që shtrihet mbi postaqinë në krahun tjetër të oxhakut...

Hani, strehë në hapësirë dhe kohë pa fund, për udhëtarë që kalojnë pranë njëri-tjetrit pa ditur kurrë për njëri-tjetrin, shkëmbejnë postaqinë e njëri-tjetrit, pa dëgjuar fatin, stuhinë, dramën, tragjedinë a gëzimin e kërkuar; para se të zhytet në gjumë të thellë, provon të kapë kuptimin e ndonjë belbëzimi jerm dhe asgjë më shumë; le të gjejë lexuesi, në këtë tregim perfekt për hanin, edhe hiret, cenet e një hani modern, fanarë dhe oxhaqe, tallaganë mysafirësh, - nishane të hanit shqiptar, ballkanik, njerëzor...; është përulja e hanxhiut para hallexhiut enigma, ngarkuar mistere, mbuluar tallaganë dhe collniku ngarkuar në shpinë thellësisë të natës, gjëmime bubullitëse stuhish, sa të prehen në strehë gjithësie, një sy gjumë për të përtërirë qëndresën përballë sfidave të reja, të pafund; dhe rrëfimi i njohur, sqimtar, perfekt i Eqrem Bashës; dhe përshkrimi i ambientit, - jo dekor pasiv por gjallëri që të fton ta ndjesh funksionin e çdo detaji, që nga kapërcimi i pragut të hanit, deri tek mbështetja e kokës tek një shtrojë e forte; i tillë edhe oxhaku i futur thellë në gropë, flakë pak, që lëshon dritë me ndërprerje, vetëm aty rrotull, sa për të shquar të domosdoshmen; njësoj edhe dy kamaret mbi oxhak, zgavra terri, dhe, "takimi" mes dy mysafirëve, dy qenieve planetësh të largëta, kurrë të parë, që stuhitë e natës pafund i bëjnë bashkë, në gjumë gjejnë njëri-tjetrin, në gjumë tretin në humbëtitë; dy udhëtarë pa emër, pa adresë, pa cak, pa zë, pa gjurmë që s'arrin të shohin as fytyrën e njëri-tjetrit, pos vetëm gërhitjen apo ndonjë frazë jerm.. kaq, artikulluar polifoni që s'harrohet...

I ardhuri, digjet të zbrazet, t'i rrëfejë tjetrit diç nga collniku që sa s'po pëlçet, atij të shtrirë në krahun tjetër të oxhakut, me shpresë, bindje se ai edhe në gjumë dëgjon, regjistron; dhe vetëm gërhitje bashkëbisede, thurje e rrjedhës, kohë e hapësirë që s'ka fund, kohëhapësirë tejpertej, këndeje e andej; ndërsa, kurrë, as takim, as bisedë, as arritje, as nisje, as nga as ku...; thjeshtë një tregim për hanin njerëzor, të përjetshëm që të ndjell dehje përsiatëse, bredhje hapësirash planetare; për hanin, strehë takimi-mostakimi mes njeriut dhe njeriut, atij dhe zotit, pa mundur të gjejnë përgjigjen as nga dhe as për ku; njeriu enigma, i njohuri i panjohuri i përhershëm....



Skicë nga Bujar Kapllani

Romani i fundit i Mira Meksit “Kutia e Agatha Christie-t”

ETHE DHE NJËKOHËSISHT MREKULLIM

Nga Diana Çuli

Mira Meksi na befason gjithnjë, me çdo libër të Mri që shkruan. Në të vërtetë, botimi i fundit i romanit “Kutia e Agatha Christie-t”, nuk duhet të ishte befasi për lexuesin që e njeh shkrimtaren, tashmë me përvojë të gjatë e me suksese të njëpasnjëshme. Për këtë lexues, ky libër i ri do të ishte *a priori* një tjetër roman i mrekullueshëm. Megjithatë, si rregull, me sa duket, shkrimtari i mirë gjithnjë të befason. Të huton me gjetjet e reja në mjeshtërinë e vet letrare, me përkryerjen e mëtejshme të stilit, me kuturisjen në tema të parrahura, në zhanre të vështirë siç është ai i romanit *thriller historik* – një ndërmarrje kjo tejet e vështirë.

Mira Meksi nuk e ka për herë të parë këtë sprovë, përkundrazi. “Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë” i saj është një gur i rëndë në shkrimin e romanit historik në letërsinë tonë, ndërsa “Diktatori në kryq” i paraprin këtij “Kutisë së Agatha Christie-t” me kontekstin historik, me misterin dhe me personazhet realë e të shpikur të ndërthurur sëbashku.

Dihet se romani historik është një zhanër letrar ku gërshetohet realiteti dhe trillimi - (*fiction*-i, si përdoret së fundmi nga ne kjo fjalë në anglisht, pa ndonjë arsye të fortë). Tek Kutia e “Agatha Christie-t” ngjarjet vendosen në një periudhë të kaluar, në atë të viteve ’20 në Shqipëri, Turqi e Ballkan, po edhe shkarazi në ndonjë qytet tjetër europian, në një kontekst historik të trazuar – atë të famëkeqit shkëmbim të popullatave me bazë fetare. Mit’hat Frashëri, personazhi real e i njohur shqiptar është në kulm të veprimtarisë së ethshme për të mbrojtur shqiptarët nga çvendosjet, shpërnguljet,

dhunimet e fqinjëve. Pra, kemi një sfond dhe një personazh historik. Por, fantazia letrare e Mira Meksit e rivendos personazhin e saj real në një situatë personale, të përshkruar me gjallëri, me detaje të panumërt, sa lexuesi ndjek tashmë këtë realitet paralel, ku jetojnë e veprojnë personazhet e vërtetë dhe ata të shpikur, disa protagonistë në ngjarjet kolektive të popullit të tyre, disa të hedhur rastësisht apo çuditshëm rastësisht mes këtyre vorbullave përfshirëse, siç është rasti i Ninetës, të dashurës së Mit’hatit, i vetë Agatha Christie-t dhe i personazhit të saj letrar apo i të famshmit Conan Doyle. I shoh këta personazhe të ndërthuren rrugëve të Ballkanit, në Stamboll, të piquen e të flasin me njeri tjetrin dhe e jetoj romanin me ëndje e me kureshtje, sepse ata janë të gjithë kaq të vërtetë e asnjëherë autorja nuk e kompromenton ‘vërtetësinë’ e tyre. Njësoj si D’Artaniani i Dumas-ë, kur bisedon me kardinalin Richelieu apo si personazhet shkrimtares Margueritë Yourcenar tek “Kujtimet e Adrianit”, ku ata historikë të Romës Perandorake diskutojnë me ata të shpikurit mbi frymëzimin reflektiv e filozofik. Apo fisnikët e salloneve të Moskës të “Luftës dhe Paqes”, që i shohim në fushat e betejave napoleonike, ku Cari, Napoleoni, Kutuzovi e personazhet letrarë janë vazhdimisht në marrëdhënie të ndryshme me njeri tjetrin. Pra, Mira Meksi, shkrimtare e sprovuar, arrin përsëri me sukses ta përballojë historinë në mënyrë origjinale dhe krijuese, duke qëndruar ‘pas kuintave’ edhe vetë, si protagoniste e rrëfimit. Arrin me sukses të padyshimtë, duke përdorur *excursus storic*, të na japë të gjallë figurat e njohura të kësaj periudhe si

Frashëri, Noli, Luigj Gurakuqi e të tjerë, duke i vënë në marrëdhënie me njerëz të thjeshtë e të panjohur nga historia, por të dalë nga imagjinata e saj. Ata lëvizin në Korçën apo Tiranën e atyre viteve, në një periudhë me dukuritë e saj të veçanta politike e shoqërore. Më tërheq e më mrekullon edhe ndërthurja e kësaj imagjinate të ndezur të autores me realizmin, një tjetër sprovë artistike-letrare aspak e kollajtë.

Ky roman, i cili nga titulli mund të mendohet një *thriller* fund e krye, është në të vërtetë një grackë e këndshme për lexuesin, duke ia mbajtur njëkohësisht frymën pezull, sepse, ndonëse kapitujt e parë përshkohen nga ngjarje, biseda e marrëdhënie jo të lidhura dukshëm me të fshehtë e pritshme, ata përshkohen ndjeshëm nga një vel misteri e ndjesie të papriture. Kjo ndjesi shqetësuese të ndjek pas gjatë gjithë kohës. Ndoshta ngaqë dashuri të tilla, si ajo e Mit’hatit me aktoren magjepsëse britanike zor se mund të kenë funde të lumtura, ndoshta se vetë jeta e angazhuar vrullshëm e Mit’hat Frashërit mund ta kishte këtë dashuri vetëm një çast të shkurtër, por edhe sepse kodet letrare të Mira Meksit paralajmërojnë se gjithçka që ajo po na përshkruan janë prelude të asaj që do të vijë më pas.

Kthesa që merr romani me ndodhitë në *Pera Palace*, periudha historike e përcaktuar shumë qartë dhe e përshtatur përsosmërisht me të gjitha aksionet e idetë e romanit, përdorimi me mjeshtëri i zhdukjes 11 ditore të Agatha Christie-t – e presupozuar të ketë



qenë pikërisht në këtë hotel - i personazheve realë britanikë e i personazheve të trilluar të Christie-t, arrestimi i Frashërit në Jugosllavi, ngrënë *suspences* të tjera. Detajet e çelësit e të kutisë, dyshimi – apo zbulimi – se Nineta mund të jetë agjente e shërbimit të fshehtë britanik, përndjekja nga shërbimet jugosllave të Mit’hat Frashërit, paralelizmi me vrasjen e personazhit të këtij romani me “Vrasje në Orient Express” të Christie-t, të gjitha këto ndërtekte, të gjithë këta elementë historikë, personalë, këto ngjarje të ndodhura në të vërtetë e jo në të vërtetë, krijojnë një vepër unike, ku çdo fije lidhet në fund me logjikë të plotë me nyjen kryesore.

Duket qartazi se Mira Meksi, si tek romanet e mëparshëm të saj me sfond historik e që i përmendëm këtu, ka studiuar jo pak. Vlera e kërkimit shkencor dhe e dokumentacionit historik është një element i padiskutueshëm dhe në këtë roman ka një peshë jo të vogël. Ose, më saktë, ka shërbyer si bazë për pikënisje të shumta, për hollësi të vjera e të dobishme dhe për krijimin atmosferës kohore në fjalë.

Por, nga ana tjetër, Mira Meksi nuk ka rënë skllave e të vërtetës historike. Ajo, në asnjë çast nuk harron se vepra e saj është gjithnjë një roman dhe, si i tillë, të vërtetat e së kaluarës kanë vlerë për të, por në thelb nuk janë protagonistet e tij absolute. Historia i shërben romanit të saj dhe jo e kundërta! Dhe, në këtë roman është forca e personazheve ajo që ka aftësinë për të ‘pikturuar’ me vërtetësi mjediset e atëhershme, që i mbeten në mendje lexuesit. Meksi e ndan me shumë saktësi e vetëdije nevojën e verifikimit shkencor dhe të dokumentacionit historik nga autonomia dhe jeta e romanit. As nuk ka rënë pre e prirjes për të dhënë dialogje tepër të drejpërdrejtë mes personazheve, që të tingëllojnë «të sotëm», duke gjetur një ekuilibër në formën e gjuhës që përdor si në rrëfim, si në dialogje – mjeshtëri që e ka dëshmuar prej kohe në veprat e saj. Arrin të përdorë përzjerjen e duhur mes epokës historike të romanit dhe lehtësisë për t’u kuptuar nga lexuesi modern.

Për të thënë dhe pak fjalë për stilin dhe metodën e punës së Mira Meksit, do të theksoja se këtu, më shumë se kudo tjetër në veprat e saj, ajo ka thurur një subjekt që nuk është i tepëruar në intrigë, por as i thjeshtë, që, megjithë kthesat e të papriturat, mbetet homogjen dhe koherent. Rrëfimi ka ritëm, gjendje pezull, kureshtje, lexuesi rrëmbehet dhe dëshiron të shkojë sa më parë deri në fund, por pa mundur të nxitojë, sepse shija e fjalës, e frazës, e gjuhës së përpunuar e të pasur e mban peng dhe e çon deri në padurim të ëmbël. Personazhet e saj janë të fuqishëm e të kuruar deri në hollësitë më të imta. Ne dashurohemi pas tyre, u zbulojmë brishtësinë e forcën. I ndjekim pas në atë botë të errët, po edhe të ndritshme të viteve ’20, të cilën Mira Meksi e ka ndërtuar rreth tyre e ku ne mikpritemi si të jemi duke jetuar jetën tonë. Është një udhëtim dhe një mister, që fillon e duhet të mbarojë, por, edhe kur mbaron, na mbetet përsëri në mendje, sepse ndjejmë që nuk mund të përsëritet, se na duket ta kemi përjetuar vetëm një herë.

Vepra përshkohet nga një dualizëm tërheqës, që e bën atë poetike, por edhe të rëndë e të fuqishme. Mes dyshimeve, maktheve, ëndrrave dashurore e përndjekjes politike, ky roman i thyen skemat e zhanrit dhe na zbulon një botë ku zhytemi, pa dashur të dalim shpejt prej saj. Mes këtyre ëndrrave dhe këtyre maktheve ka dhe diçka tjetër, që mezi presim ta zbulojmë. Është ethe e njëkohësisht mrekullim!



Libri me tregime i Zija Çelës, "Thika pa gjak"

BUKURIA E RRËFIMIT DHE LARMIA E SUBJEKTEVE

Nga Halil Rama

Shkrimtari i mirënjohur Zija Çela, Nderi i Kombit, për vetë vlerat e krijimtarisë së tij letrare është padyshim ndër më të preferuarit e lexuesit. Nëse tri vitet e fundit jemi mrekulluar me romanet "Djalli komik" e "Lavjerrësi i qytetit", këtë fillim vere ai na dhuroi "Thika pa gjak", që sapo është vënë në qarkullim nga Onufri. Një vëllim i strukturuar në tri pjesë, secila me nëntitullin e saj, gjithësej 54 tregime që të magjepsin me lëndën e larmishme, bukurinë fjalës dhe forcën tërheqëse të leximit. Pavarësisht nga mjediset apo vendi ku zhvillohen ngjarjet, të gjitha tregimet sjellin tema të aktualitetit dhe janë trajtuar, siç ndodh në krijimtarinë e Çelës, me frymën e universalitetit.

Me të drejtë, në përcjelljen e librit, prozatori e poeti Besnik Mustafaj ka theksuar kur shkruan: "Sado improvizues e spontan që është Zija Çela gjatë shkrimit, tipar ky që zbulon poetin brenda tij, ai e ka megjithatë të qartë Itakën ku do të mbërrijë dhe nuk hutohet gjatë rrugës, gjë që i jep rrëfimit të tij një qartësi, një dinamikë dhe një ritëm të lartë." Pikërisht rrëfimi i qartë, dinamika dhe ritmi i lartë përshkrijnë tregimet e Çelës. Lakonizmi spikat edhe në tregimin, i cili i jep titullin këtij libri. Autorit i mjaftojnë pak radhë në tregimin "Thika pa gjak", për t'u ndalur thekshëm te tradhtia bashkëshortore, kjo plagë e rëndë e shoqërisë njerëzore, që rrëfihet nëpërmjet dialogut mes dy personazheve. Njëri prej tyre është Leli Makulla, që dyshon në tradhtinë e së shoqes. "Dhe që, si burrë pa këllqe për tradhtinë, i kthehet vetes: Jo, jo, nuk është ajo! Se ime shoqe lë kokën pas meje...e rrena të tjera, e dokrra pa kokrra."

Pasi rrëfihet fare shkurt, por bindshëm artistikisht, prova e hidhur që kishte kaluar Leli Makulla, kur para Motel Nevadës, nga xhami i makinës, kushëriri kishte parë gruan e tij me një zotëri burrë, teksa zbrisnin shkallëve të fjetores, "zgjidhja" jepet në paragrafin e fundit: "E vrava, pra! I thuaj policisë se nuk jam larguar nga shtëpia." Ndërsa më tej autori shkruan: "Kishin kaluar tetëmbëdhjetë vjet nga lajmi i kushëririt për Magdën dhe Nevadën. Qysh atëhere e kishte mbajtur dyshimin në zemër si thikë pa gjak."

Këtë plagë të shoqërisë njerëzore, Zija Çela e trajton mjeshtërisht edhe në tregimin "Deri në fund", kur dy personazhet, Asllani dhe Bilani, pasi rrëfejnë ëndrrat duke bërë seks me gratë e njëri-tjetrit, e kërkojnë me ngulm të verbër tragjikën, ata vrasin njëri-tjetrin...

"Sikur janë zgjuar të palumturit e botës..."

Mehmet Kraja, që spikat vetë në fushën e letrave, e vlerëson "Thika pa gjak" si "një libër të shkëlqyer, të atillë që dinë të bëjnë mjeshtërit e prozës dhe të shkrimit letrar." Për shkrimtarin dhe analistin e mirënjohur Kraja: "Këto tregime, shkruar me synimin e artit sipëror, sjellin shqetësime jetësore, trazime e reflekse meditative të njerëzve, që duan të shprehen për brengat e tyre të thella, plagët metaforike të thikave pa gjak. Të palumturit e botës sikur janë zgjuar, u ka ardhur radha dhe duan të flasin."

Dhe pesonazhet flasin vërtet, duke zbuluar pengjet e dramet e jetes. Nuk flet vetëm psikologu te "Timoni", që e ka të vështirë t'i përgjigjet Evelinës për seksin, pasi ndodhet në konflikt interesi, ndërsa për timonin ai i sugjeron të rishqyrtojë vetveten. Por kjo, sipas tij, "nuk do të thotë se jeni thes me silikon ose kurvë!"

Flet edhe Tone Marashi, pronare e Bar Motra Tone në tregimin "Shuplaka e motrës". Megjithëse gazetari dëshmitar del pro saj në gjyqin me Sedat Mahollin, i cili përgojonte prostitutat, prapëseprapë ajo do të shpërthejë në fund edhe ndaj tij: "E ç'burrë je ti që nuk ia ngjeshe turinjve atij horri, kur e dëgjove të ndynte gojën në prani të Motrës Tone!"

Flet edhe Bushkashi te "Halli i burrit", kur shprehet se do t'i donte parmakët e ballkonit "të forta e të bardha, si këmbët e zonjushave".

E kështu, "të palumturit e botës" sikur janë zgjuar dhe flasin, sa të mahnisin me bukurinë e magjinë e fjalës në dhjetra tregime të Zija Çelës.

Ndërkohë, si risi e prozës së shkurtër të autorit, është për t'u vënë re edhe mënyra si u qaset ai emrave të personazheve. Të tillë janë: Genti Meniku në tregimin "Margarita dhe tollumbace"; Andrea de Roca në Castelnovo te tregimi "Cili je dhe cila është"; Rudi Strazimiri te "Brezi i shkretëtirës"; Izabela Leonardo Dimikele dhe Rajmond Fransua te "Basti Final"; Anita Bokanini e Bernard Habacia te "Gropa thithëse"; Damian Roshi te "Demi në thes" e shumë e shumë emra të tjerë, që të ngazëllojnë herë me karakterin, herë me profilin e tyre të ndërtuar mjeshtërisht nga Zija Çela, përfaqësues i denjë i letërsisë bashkëkohore.

Këtë ndjenjë provon edhe gjatë leximit të tregimit "Tregtarë të tymit", ku rrëfihet historia e Markut, i cili u kthye nga Amerika si Majkell dhe e Gjinit, që në Amerikë u vetëquajt Xhimi...

Niveli i lartë artistik i një mjeshtri të denjë

Shkrimtari i mirënjohur Lazër Stani, i befasuar nga bukuria e rrëfimit, evidenton te libri "Thika pa gjak" larminë e subjekteve, natyrshmërinë, ritmin, muzikalitetin dhe ngjyrimet e fjalës, trillin dhe lakonizmin, si veçori të pranishme në secilin prej tregimeve. Duke e konsideruar një koleksion rrëfimesh sa shqiptare po aq universale, ngjizur me fantazi të pashtershme kreative dhe të harmonizuara në një libër të strukturuar gjithë origjinalitet, Lazër Stani konkludon: "Thika pa gjak" dëshmon sërish nivelin e lartë të këtij mjeshtri të denjë të prozës së shkurtër, që edhe në letërsinë botërore nuk janë shumë."



Kështu, si rrallëkush, autori trajton plagët sociale te tregimet "Banka e ankesave", "Koha e qenve", "Mis luga" etj, ku tek ky i fundit MIS është Ministria e Iluzionit Social. Duke marrë gjithnjë shkas nga jeta, fantazia e autorit nuk ka të sosur, prandaj sjell me elegancë edhe ironinë e sarkazmën.

Si në disa romane, edhe në këtë vëllim me tregime, Zija Çela dëshmohej gjithashtu njohës i jurisprudentës. Kjo reflektohet në disa tregime ku, me trille artistike mbresëlënëse, hasim njëkohësisht viktimën, hetuesin, prokurorin, dëshmitarët dhe gjykatësin.

Në koherencë me realitetin, Zija Çela trajton me vetëdije të lartë artistike tema nga më të mprehtat. Nëse te "Banka e ankesave" rrëfen zyrtarin burokrat, i cili nuk ngurron t'i thotë qytetarit se ankesës së tij mund t'i vijë radha për t'u shqyrtuar pas dy-tri viteve, te "Tregtarë të tymit" gjejmë të famshmet PPP dhe sipërmarrës të pasuruar përmes tenderave me prokurim të drejtpërdrejtë. Po përmend kalimthi gjithashtu "Blu dhe Mavi Mbretërore". Duke iu referuar gazetarit të huaj Frenk Uiliams, i cili kishte ardhur në vendin tonë për një reportazh, lexojmë: "Përpara se të përgatiste leksionin për studentët, me gjithë kërkimet e tij intensive, në tërë lëmshin tokësor asgjekund tjetër nuk kishte mundur ta gjente termin *Media kazan*".

Ndërsa te tregimi "Alpinisti", nga personazhi interesant Flavio Markoni që kishte arritur të ngjitej në Everest, na thuhet në mënyrë metaforike: "Ekziston një mal tjetër, që është rreth gjashtëmijë metra më i ulët se Everesti. Dhe ndonëse e kam provuar dy herë, nuk kam mundur ta pushtoj. Ky mal është Olimpi."

Perifrazime si shprehje filozofike

Nëse gjatë leximit të librit "Thika pa gjak" ndeshim fjalë e fjali të rralla që na nguliten në memorie, si: "...vetëm në atë vendin e çuditshëm, ku as shtëpia nuk është e pronarit, por e Zotit dhe e të huajve" (*Blu dhe mavi mbretërore*); "Njerëzimi njëlloj humbet, si po të harrojë me qeshë, si po të harrojë me qa!" (*Mali i jetës*); "prapanica e pulës ia dhjeu tërë imazhin romantik" (*Hëna në tigan*), në tregimet e shkurtra të pjesës së tretë, nëntitulluar HOROSKOP, gjejmë tregimtarin filozof me thënie të atilla proverbiale, që mund të shërbejnë si postulate. Ja disa prej tyre:

"E ndiej si shkallëve të hierarkisë gjëmon kori servil dhe si njerëzorja nuk ka më vlerë, kur baltë bëhet dinjiteti dhe nderi qenërisht hidhet në erë."

"Një grua, një grua, për Qiell e për Tokë, edhe Zot të bën kur ta jep në kokë."

"Qysh se më pate prekur, më ka zënë një hekë, thua se dua me vdekë."

"Zogjtë që bashkë fluturojnë në vjeshtë, shkojnë drejt rrufesë së dimrit."

"Megjithëse nuk ke më pak vrulle epshi, ajo mbretëresha tjetër, bilbilesa, të ka zëvendësuar me lodra seksi."

"Duket sikur hëna e ka shpejtuar lindjen dhe dielli e ka vonuar perëndimin, vetëm e vetëm që të ndodhen ballë për ballë." Apo: "Poshtë, pak para meje, një fije bari si gjuhë nepërke përqesh pleqërinë time..."

Lexon Zija Çelën e të vjen të thuash: "Faleminderit, Mjeshtër, letërsia juaj është e paharrueshme."

Resul Shabani: “Mëkat i trilluar”, “Onufri”, Elbasan, 1996

IDENTITETI I SË PËRGJITHSHMES

Nga Shaban Murati

Vëllimi “Mëkat i trilluar” noton në ujërat e pjekurisë, e krijmtarisë së poetit dhe shkrimtarit, dramaturgut, përkthyesit Resul Shabani. Hulumtimi i shpirtit dhe i fjalës në poezinë e Resul Shabanit është veprim e kërkim poetik prej një poeti që e njeh dhe ndjehet në poezi si në shtëpinë e tij, që din ku të kërkojë e të gjejë atë që don, që din si dhe ku të zbukurojë, që din kur dhe sa të trishtohet apo psherëtitë. Poezia e Resul Shabanit është poezi e mendimit të thellë, meditativ e emocional paralelisht, që kërkon angazhimin e kritikës për zbërthimin e vlerave të saj. Unë do të cek disa tipare, të cilat më tërhoqën më shumë në këtë vëllim dhe që natyrisht nuk janë as të vetmet dhe as më të plotmet e “Mëkati i trilluar”. Një tipar poetik që bie në sy është identiteti i së përgjithshmes. Njihet se në shtjellimin poetik e veçanta, e përveçmja, që sjellin edhe impresionet e ngacmimet e para të drejtpërdrejta, janë më të lehta në kompenzim dhe asimilim. E përgjithshmja e konkretizuar, është më e vështirë dhe ajo kërkon dhunti e mjeshtri poeti. Gurë, liqej, pyll, dru, dhimbje, ka kudo në poezinë shqipe, të vjetër e të re. Por tek Resul Shabani, siç ndodh edhe me

shumë poetë të shquar, ndjehet qartë se ato janë pjesë dhe simbol i qenies së tij personale dhe kombëtare. Ai ndjen, kupton e zbërthen shqip, gëzohet, trishtohet, filozofon shqip. Nga ky vizion i parë i së përgjithshmes së konkretizuar ai gjen pastaj dyert për t’u shpërndarë në përgjithësimet e mëparshme mbi kombet, mbi kufijt, mbi kohët.

Për poetin çdo gjë është rebus. Edhe e kaluara: qoftë në kohë, qoftë në vend. Po e kaluara tek “Mëkati i trilluar” është vazhdimësi pa fund, siç e kërkon arti i mjeshtresë poetike. Tek Resul Shabani nuk ka toponim në vjershat. Në një rrethanë kjo mund të jetë dobësi, në një rrethanë tjetër (sado absurde të duket) është pikërisht toponimi. Poeti “përpëlitet të shkruajë dhembjen e vetë me shkrimin e palexueshëm të testamentit e asgjësë”, po lexuesi e sheh dhe e ndjen se ato janë nëntë plagët e Gjergj Elez Alisë, tek Mani i Kalishtit lëkundën armët e Pal Golemit, tek Ura e Strugës gjen urën e Qabesë dhe të Bunës, te kisha e nuses së vëllait gjen Doruntinën. Poeti arrin përmes artit të tij të rafinuar poetik njësinë shpirtërore me popullin, me racën, me ekzistencën dhe, me ferrin dhe parajsën e popullit që i takon.



Vëllimi “Mëkati i trilluar” kapërthehet nga një nerv i tendosur i kërkimit poetik në gjithë vargun, figuracionin, organizimin e fjalorin e vet poetik. Resul Shabani nuk është poeti i thinjur mbi artin poetik, që vetëm shfleton albumin e kujtimeve dhe interpretimeve të tij. Ai kërkon pa-jada, hap dyer, çan fjalë e shqyen kuptime, zbërthen edhe tinguj edhe heshtje, nuk është i kënaqur dhe kjo forcë e brendshme e shpirtit poetik e bën atë të lëvizë, të kërkojë, të konfigurojë një poezi që paraqet nivele.

Resul Shabani duke qenë i lindur dhe dashuruar me liqenin, shpesh identifikohet me të nga kritika. Kjo është arritje dhe çdo poet aspiron ta identifikojë



me liqenin apo shkëmbin ku ka lindur. Por unë do të thoja se Resul Shabani është më shumë poet i detit me tallaset, shkëlqimet e dallgëve, me trazimet dhe shqetësimin dimensional që sjell. Këtë permasë filozofiko-poetike unë do ta cilësoja vlerë të poezisë së tij.

Resul Shabani është poet i kërkimit vertikal, i zgjimit të thellësive, siç e përkufizon misionin e poezisë miku im dhe një nga poetët më të shquar shqiptarë, Xhevahir Spahiu. Si mjeshtër i konfirmuar i fjalës poetike autori nuk kërkon misionin vetëm në fushat e pamata të tematikës, ku mjaft të lëshosh Pa gesin dhe arrin deri tek vjersha. Ai i hyn shtegut poetik të kërkimit të ri në temat dhe pikat e njohura të horizontit poetik. Bilbili, Korbi, Pylli, Trungu, Mani, janë pika të kënduara që kur lindi poezia, por sa të jetë poezia do të ketë diçka për të gjetur apo për të përthyer poetikisht në këto pika. Dhe Resul Shabani këtë dimension synon t’i japë poezisë së vet, “Mëkati i trilluar” plotëson edhe më qartë portretin krijues të poetit, si një nga përfaqësuesit me seriozë dhe me të talentuar të popullit shqiptar në Maqedoni.

KANUNI DHE "PRILLI I THYER" I KADARESË

Nga Mehmet Elezi

1.

Në romanin *Prilli i Thyer* Kadareja përcjell artistikisht madhështinë e mrrolët të botës së Kanunit, fuqinë dhe tragjizmin pa fund, për të cilin thua se vetëm ato male me kreshta të rënda e thepa qiellorë, ku thërmohen e vdesin rrufetë, mund ta durojnë e ta mbajnë në shpatulla dhe vetëm atyre u ka hije tërë ajo peshë mbi jetën dhe vdekjen bashkë.

Ndryshe nga sa përsëritet herë mbas here, as tërthorazi, me mjetet e artit, autori nuk thotë kund se shkretimi vjen prej ligjit të Lekës. Ndërkohë ndihen stërpikët e gjakut të freskët, ato enden nëpër atmosferën e romanit, shkrihen nëpër kokrrizat e ajrit. Hija e tyre është e pranishme gjithkrah, edhe pse nuk mund të preket. Një shije e dyshimtë të mbetet pas leximit të parë: sikur Kanuni është nxitës i hatasë, çartan idhnak që ndez vrasjet në reaksion zinxhir; sikur ai mund të çojë deri në shuarjen e familjeve, fiseve e viseve, siç ndodh në Rrafsh.

Plaka psherëtiu thellë.

-Nga dyqind shtëpitë e fshatit vetëm njëzet s'janë në gjak. Do ta shikosh o bir. Katundi ngjan krejt i gurosur, sikur ka rënë murtaja.

2.

Një përfytyrim kësisoj për mbretërinë e Kanunit lidhet me pleqërinë e thellë të tij. Me kohën kur pushteti i tij i mirëfilltë po shpërqëndrohej, po *decentralizohej*, në të mirë të kanuneve të fiseve. Fiset dhe ligjet e tyre vendore po merrnin më shumë kompetencë. E kishte vënë re me mprehtësi At Zef Valentini, kur thoshte s'ka ndryshuar Kanuni, por kanunet.

Hahni përmend një trandje troshitëse në male.

Selca mblidhet në kuvend, merr vendim me lypë gjakun vetëm tek ata që jetojnë në një shtëpi dhe që hanë bukë në një sofër me vrasësin. Pra mos me lypë gjak në farefis. Madje as te baba e te vëllai, në qoftë se këta nuk jetojnë bashkë me dorasin, nën një kulm.

Kur ka çashtje me randësi, vojvoda kërkon pëlqimin e të gjithë popullit, bile nganjherë i len me ba bé për nderin e armëve... që do t'i binden vendimit të ri... Këtë p.sh. e bani Selca disa vjet përpara, ku populli vendosi që hakmarrja të përfshinte vetëm ata persona të cilët jetonin me vrasësin në një shtëpi dhe në një voter, dhe jo edhe farefisin, qofshin edhe ati ose vëllai i vrasësit. Ai që do të vepronte kundra këtij ligji, përveç pareve të gjakut që duhej t'i paguente pashës, detyrohej të paguente edhe nga 1000 pjastra gjobë hem pashës, hem fisit.

Ç'është ky vendim për të mos e kërkuar gjakun në farefis? Kanuni s'e ka pasë kërkuar gjakun në fis as në farefis. As në familje jo. Kanuni thotë *gjaku për gisht*, krye në krye. Vetëm dorasi me u përgjigjë. Askush tjetër. Të afërmit duhet me u ruejtë vetëm 24 orët e para pas vrasjes, kur gjakrat vlojnë. "I dami i zjarmit

jashta 24 orvet nuk i ruhet gjaksit".

Paragrafi i sipërpërmendur i Hahnit, edhe pse i shkruar në kontekst tjetër, ka fotografuar lëvizjen tektonike më të rëndë, më shkatërruese, në tërë jetën qindrvjeçare të Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Fotografia është marrë me vonesë, kur objekti është larguar, është marrë nga pas, me synim tjetër. Megjithatë spikama dallohet qartazi diku në hapësirë. Ashtu siç shihet drita e yjeve të vdekur shumë e shumë kohë më vonë, sepse është në udhëtim nëpër gjithësi, ashtu vjen nëpërmjet këtij paragrafi edhe pamja e përflakur e vendimit me e marrë gjakun në fis. Vjen pasi ky vendim është shfuqizuar!

Ajo çka ka ndodhur përvijohet pak a shumë në këtë mënyrë:




Në Selcë paskesh qenë bërë një kthesë e fortë në Kanun. Kthesë e fortë? Jo kthesë, përmbysje e njëmendtë. Paskesh qenë përmbysur neni më delikat, përse i përket paqes shoqërore e sigurisë së jetës. Neni që lyp shpagimin e gjakut vetëm te dorasi dhe jo te kush tjetër sado i afërt. Dhe qenkesh vendosur: gjaku mund të merret duke ia njehur plumbin ballit cilitdo në fis!

Sipas një tjetër dëshmie të Hahnit, gjakmarrja brenda fisit dhe jo vetëm ndaj dorasit tashmë njihej edhe në jug të vendit. Madje në Jug ishte e përhapur dhe njihej vetëm kjo gjakmarrje, jo tjetër. Duke përshkruar doket nëpër fshatrat e Rrëzës, në Tepelenë e Delvinë, ai thotë:

...gjithë fisi asht përgjegjës solidar, kur një prej anëtarëve të tij ban ndonji faj p. sh. kur ban ndonji vrasje. Prandaj i gjithë fisi bie në gjak, kur një prej anëtarëve të tij ban një vrasje. Nga ky shkak kur pajtohen me anmiqtë, të gjithë anëtarët e fisit kontribuojnë për me la shumën e caktueme. Nganjëherë ndodh që i gjithë fisi asht largue krejt nga fshati për me shpëtue nga hakmarrja!

Bie në sy te Nopça: lidhur me gjakmarrjen, flet për "ligj të vjetër" dhe për "ligj të ri" në disa fise. Ai që quhet "i vjetër" nuk është ligji i Kanunit *gjak për gisht*, por është ligji që e zëvendësoi atë, duke shtrirë marrjen e gjakut në fis. Dhe ai që quhet "i ri", nuk është ligji që shtriu marrjen e gjakut në fis, por është rrëzimi i këtij ligji, duke e ngushtuar prapë rrezen e marrjes së gjakut, duke e ribërë pothuaj siç është shkruar në Kanun. "Sipas ligjit të vjetër duhej të binin në gjak të



gjithë burrat e farefisit të vrasësit...”. Ndërsa sipas të riut “malli i përbashkët (domethënë prona ose plangu i përbashkët - m. e.) është kriter kush përfshihet në hakmarrje”, pra gjakmarrja kërcënon vetëm ata që jetojnë nën të njëjtin kulm.

Kjo do të thotë se edhe në fise të tjera, kush më përpara e kush më mbrapa, ishte ajo gjendje *reflektimi* e pendese si në Selcë, për të cilën flet Hahni. Fise që para disa dhjetëvjeçarësh kishin rrëzuar nenin që bën përgjegjës vetëm dorasin, po lëkundeshin e po përqendroheshin prapë te *dorasi*, te parimi i Kanunit *gjaku për gisht*. E shumta, te njerëzit e një zjarri, që jetonin bashkë nën një kulm e hanin në një sofër, pra që kishin ekonomi të përbashkët. Më gjerë jo. Ky ishte “ligji i ri”. Në thelb afër ligjit të parë, të shenuar prej Gjeçovit.

Prandaj Gjeçovi thotë se vrasja e një tjetri sado të afërt në vend të dorasit “nuk ka kenë”. Sepse s’kishte qenë në Kanun.

Nuk thotë është tashti. Sepse, me gjithë përhapjen, lypja e gjakut në fis nuk qe shtrirë gjithkund. Madje në vende ku qe ligjësuar po lëkundej, po çthirrej (revokohej), po çligjësohej. Fiset po riktheheshin ku patën qenë.

Atëherë Kanuni është nxitës gjaku apo parandalues?

3.

Te *Prilli i Thyer* Kadareja shtron rolin e Kanunit në të dy anët. E shtron si mendimrrahje të botës intelektuale, pa mbajtur qëndrim drejtpërdrejt.

Nganjëherë kureshtja e shtynte të dëgjonte me orë të tëra ç’thuhet në ato fletë, siç ishte rasti i përsiatjes së një reviste, ku shqyrtohej çështja nëse Kanuni me ligjet e tij të rrepta e nxiste gjakmarrjen, apo, përkundrazi, e pengonte atë. Një palë shkruanin se disa nga nyjet themelor të Kanunit, si ai që thoshte se gjaku nuk humb kurrë dhe se gjaku lahet veç me gjak, e ngucnin hakmarrjen, pra ishin nyje barbare. Të tjerët, përkundrazi, këmbëngulnin se nyje të tilla që në dukje dukeshin të kuqedërshme, ishin në të vërtetë nga më njerëzoret, sepse pikërisht duke e bërë ligj larjen e vdekjes me vdekje e paralajmëronin vrasësin: mos derdh gjak, se do të përgjakesh edhe ti pastaj.

-nga përsiatjet e qehajait të gjakut Mark Ukaçjera, në bibliotekën e kullës së Oroshit -

Vetëm duke e shtruar kështu Kadareja bën herezi. Hedh farën e dyshimit mbi gjithë sa thoshte asokohe përhapësimi (propaganda) zyrtar për Kanunin e Lekë Dukagjinit. Fton me arsyetue: ndal apo cyt gjakun? Thirrja me arsyetue është thirrje kundër dogmës zyrtare. Në parim çdo arsyetim, si i tillë, është kundërdogmë.

Shkrimtari guxon më tej. Shkruan se nga fundi i qindvjetëshit të 17-të, në malet ku Kanuni ndihej i gjithëpushtetshëm gjakmarrjes po i vinte fundi, ajo gati po vdiste. Kërdia u bë më pas, kur Kanuni nuk e kontrollonte më si dikur gjendjen në bazë dhe kërkimi i gjakut u shtri në tërë fisin.

Dukej sikur gjakmarrjes po i vinte fundi. Por në kohën që dukej se po vdiste, ajo kishte shpërthyer me një vrull të ri. Viti 1691: dyfishimi i gjaqeve. Viti 1693: trefishimi, 1694: katërfishimi. Kishte ndodhur një ndryshim themelor në kanun. Marrja e gjakut, që gjer atëherë binte vetëm mbi dorërasin, pra mbi njeriun që kishte shtirë me pushkë, tani ishte shtrirë mbi krejt fisin. Vitet e fundit të shekullit që po ikte dhe vitet e para të shekullit të ri u përgjakën fund e majë. Gjendja kishte vazhduar kështu gjer pranë mesit të shekullit, kur ishin dukur shenjat e një thatësire të re. Ja viti i thatë 1754. Më vonë 1799. Një shekull më vonë, tri vite rresht, 1878, 1879, 1880, por të gjitha këto ishin vite kryengritjesh a luftërash me të huajt, kur zakonisht gjakmarrja binte.

-nga përsiatjet e qehajait të gjakut Mark Ukaçjera, po aty -

Në një farë mënyre Kadareja e liron Kanunin nga një përgjegjësi që ia veshin pa e pasur, ia zbardh fytyrën e nxirë nga sulmet e lukunive me keqdashës dhe turmave me të paditur. Këta përrenj gjaku janë të jashtligjshëm. S’kanë të bëjnë me ligjin e mirëfilltë, të njëmendtë, mbledhur prej Gjeçovit, i vetmi që ka pasaportën e Kanunit. Kanuni i Lekës thotë prerë: fisi nuk preket, madje as vëllai, as baba, as djali, përgjegjës për gjakun është vetëm dorasi, gjaku lypet vetëm për gisht, një me një.

Këta përrenj gjaku janë pjellë e kipcit të rremë, *contresfaçon*, që doli në treg dhe nuk fitoi kurrë besimin e plotë, nuk u pajis kurrë me *licensë*. Lidhen me anarkinë që fillon me atë ndryshimin themelor shkatërrues që po fitonte hapësirë te kanunet e fiseve duke synuar

bash zemrën e Kanunit, me kërkesën me e shtri lypjen e gjakut nëpër fis. Pra me kohën kur Kanuni në bazë pësoi lëkundjen vrastare, të pashpresë, nëntëballëshe, në një rrethanë që nuk është plotësisht e qartë ¹. Struktura e tij u ligështua, u zhgadhnuua, arkitektura u plasarit. Diçka e rëndë u shkoq në zemër të tij. U shkoklua e u shpërbë. Gjithsesi kjo trandje gjakatare nuk u sanksionua kurrë në Kanun. Përkundrazi, siç dëshmon Nopça kur flet për “ligj të vjetër” dhe për “ligj të ri”, pasi kishte zënë vend ku e ku në kanunet e fiseve, ajo filloi me u tërheqë pa u ligjësuar në kodin madhështor të maleve.

Me sa është në dijeni autori i këtyre shenimeve, asnjë studiues a kritik letrar s’e ka qitur në pah këtë *herezi* të kujdesshme, por krejt të qartë, të shkrimtarit të madh. *Prilli i Thyer* bie ndesh me politikën zyrtare të kohës.

4.

Edhe nga pikëpamja e teknikës së konceptimit të veprës: autori nuk përzgjedh “personazhe tipike në rrethana tipike”, siç kërkonte i ashtuquajturi realizëm socialist. Bën atë që bën letërsia e madhe, merret me të veçantën. “Madhështia e artit nuk është te zbulimi i asaj që është e zakonshme, por asaj që është unike”, thotë nobelisti Isak Bashevis Singer.

Kjo herezi godet nga brenda edhe atë shije disi komprometuese, që duket sikur mbetet pas leximit të parë me një frymë të *Prillit të Thyer*.

5.

Gjithsesi duket se atmosfera me pikla gjaku në roman autorit i ka ardhur për shtat. Për dy arsye.

E para, e natyrës artistike.

Me skemën e përshtatur vepra bëhet më tërheqëse, thellësisht tronditëse. Përmasat e dramës rriten rrungajë, shkojnë shpërthyeshmë deri në kufijtë e një tragjedie të krahasueshme me epidemitë shfaruese. Po të përdorim një shprehje të autorit nga sprova për Eskilin, fataliteti rri sipër gjithçkaje si një diell i ftohtë, prej të cilit nuk shpëton dot. Pa fatalitetin e këtij dielli të ftohtë, me gjithë gjeninë shekspiriane të Kadaresë, nuk mund të jesh i sigurt nëse *Prilli i Thyer* do të dilte më shumë se *Prilli i Thatë*.

Prilli i Thyer është roman, është art. Nuk është studim, nuk është as provë. Shkrimtari krijon figurën letrare, luan me faktet. Shkrimtari punon me mjete të tjera nga studiuesi a shkencëtari, të cilët mbështeten te të dhënat e ftohta, te logjika e fakteve, pa i lënë shteg fantazisë.

Arsyeja e dytë lidhet me politikën.

Kanuni ishte fyer e shkëlmuar, ishte zhiguar e nxirë pafundësisht nga diktatura dhe drejtpërdrejt nga diktatori, ishte paraqitur si ama e tërë të ligave të dheut, si superpërbindësh vampir, të cilit sa më shumë pi gjak i shtohet etja për gjak. Edhe një Kadare me përmasat e tij e kish të pamundshme me dalë krejt hapur në kundërvënje me qëndrimin zyrtar, megjithëse në roman guxon shumë. Vetë shkrimtari ka pohuar se duhej paguar një taksë, për të pasur mundësinë me shkruar e me botue veprat. Me gjasë shija që ngelet pas një leximi të shpejtë bën pjesë në llogarinë e kësaj takse. Ani pse fatura që shkrimtari paguan për këtë taksë në roman mund të quhet e rreme, mashtruese. Kjo shije, atmosfera me pikla gjaku të freskët, është më shumë një lëpë a tymnajë, një lloj veli, nën të cilin fshihen të vërteta me peshë.

A thua te kjo taksë gjindet edhe shtjellimi, shpjegimi, për një farë shpërfilljeje ose lënijeje në hije që Kadareja i bën parimit madhërisht njerëzor të Barazisë së Gjaku në Kanun?

Nga sprova e autorit *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, botim i dytë i plotësuar, *Gj. Fishta*, Tiranë, 2019.

Foto © Aldo Bonata



1 Në botimin e dytë të plotësuar *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, Gj. Fishta, 2019, autori, për herë të parë, shtjellon arsyet pse ndodhi ky ndryshim thelbësor në kod.

NJË SKICË E PROMETEIKES NË LETËSINË SHOQIPE, NGA DE RADA TEK PORADECI

Nga Skënder KARRIQI



Kur është fjala për shtjellimin e temës prometeike në letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë, që në fillim ndeshesh me mungesën e pranisë së drejtpërdrejtë të heroit mitologjik, titanit Promete, edhe pse ai është universalizuar përgjatë shekujve letrarë. Tek asnjë nga autorët e këtyre dy periudhave letrare nuk rimerret Prometeu dhe miti i tij në kuptimin e subjektit letrar, me anë të të cilit të parabolizohen ide të Rilindjes Kombëtare apo të Pavarësisë. Gjithashtu ai nuk përmendet si hero modelues apo frymëzues, në një kohë që formimi kulturor dhe letrar i autorëve të të dyja periudhave dëshmon njohjen e antikitetit klasik dhe periudhave të mëvonshme kulturore-letrare evropiane e më gjerë. (Duhet përjashtuar këtu rasti i Konicës, për të cilin do të shprehemi më poshtë, sa na lejojnë përmasat e këtij shkrimi).

Gjithsesi, në letërkëmbime apo biseda, siç është rasti i De Radës, Prometeu përmendet në mënyrë të atillë metaforike, me të cilin autori vetidentifikohet, duke shenjuar me figurën e titanit gjithë aktivitetin e vet letrar dhe joletrar, por gjithsesi, politik. Po në krijimtarinë poetike të De Radës, këtij themeluesi të letërsisë së mirëfilltë artistike shqiptare, gjejmë hijen e Prometeut tabu, të eufemizuar si perëndia që nxori njeriun në dritë, shohim gjithashtu, ngjashëm me Gëten, figurën e krijuesit që gjen brenda vetes pishtarin me të cilin ai do t'u ndriçojë brezave udhën e lirisë dhe të progresit. Këtë ndjesi të brendshme De Rada do ta ngrejë në nivelin e një parimi estetik, që duhet të dallojë cilësisht veprën letrare. Tek krijimtaria poetike e De Radës e ka zanafillën edhe heroit lirik shqiptar, i sublimuar në hapësira dhe distanca majëmalesh, kodrash, brigjesh, çukash, timbash etj, veçori romantike kjo, të cilën studiuesit e shohin të lidhur në pikëpamje gjenetike, me serinë e imazheve të Prometeut të lidhur në shkëmbin e Kaukazit. Së fundi, gjejmë tek De Rada, projektin ideal të Shqipërisë së pavarur, asociuar me imazhin dritësor të yjeve dhe të ditës së bardhë. Ky projekti ideal i De Radës për të ardhmen e Atdheut të të parëve s'ka se si të mos jetë i lidhur me dritën shkëlqimtare që i jep kuptim ati (projektit) ngjashëm me projektet ideale të romantikëve evropiane, veçanërisht preromantikut Gëte.

Në krijimtarinë poetike të Naim Frashërit, ideja dhe disponimi prometeik vijnë me metaforën e qiririt, që sakrifikohet për ndriçimin dhe vëllazërimin e njeriut, si dhe nëpërmjet metaforës së fyellit, si parabol e heroit të pakuptuar, që vuan për njerëzit, por

më shumë vuan faktin që është i pakuptuar prej tyre. Gjithashtu, Naim Frashëri, në mënyrë qartësisht poetike, vjen edhe si hero i lirë i sublimuar në lartësi majëmalësh dhe në marrëdhënie me distanca hapësinore, nga ze fill poetizimi i atdheut. Kaq mbresëlënëse është imazhi sublim i tij në këto rrëthana, sa ai dominon gjithë krijimtarinë poetike naimjane, pas botimit të poemës *Bagëti e Bujqës* (1886). Është imazhi prometeik me të cilin vetëpoetizohet poeti i atdheut.

Në imazhin prometeik të poetit që mediton në distancë majëmalë duke sjellë perceptimin poetik të fshatit *.../... me kish' e me varre, / Rrotull ca shtëpi / Të vogëla fare*, shenjë kjo e poetikës së distancës romantike në raport me objektin poetik, vjen edhe Çajupi me vëllimin *Baba Tomorri*. Pikërisht nga kjo distancë majëmalë hero i lirë mediton për gjendjen e mjeruar të gruas shqiptare dhe stigmatizon moralin maskulin, që e legjitimon atë gjendje.

Tek poemthi *Liria*, Mjeda do të vijë me imazhim e heroit prometeik të izoluar. Edhe pse në rrëthana të tilla, ai e tejkalon shërbëtorin e Zotit dhe i drejtohet simbolit totemistik të shqiptarëve, Shqipes, për të mësuar të ardhmen e lirisë së popullit shqiptar. Më pas teksti modelohet në mënyrë të atillë, që eklipson dialogun e Shqipes me poetin. Në mënyrë të nënkuptuar, thelbi i këtij dialogu është informacioni mbi lirinë e Atdheut dhe të ardhmen e tij, informacion ky që vjen së larti; jo nga muza antike apo Zoti unik, por nga totemi i shqiptarëve, falë topikës dominuese në lartësi dhe hapësirë. Në këtë mënyrë autori legjitimon vetën prometeike si trumbetar i lirisë, hero prometeik që zgjon politikisht popullin dhe e orienton zemërimin e tij për kah liria.

Në poezinë e Nolit, prometeikja vjen në imazhin e çlirimtarit, por dhe heroit të pakuptuar, nëpërmjet poetizimit episodik të subjektit biblik mbi jetën e Mojsiut dhe Jezus Krishtit, përkatësisht në poezitë: *Mojsiu në mal, Krishti me kamçikun, Marshi i Krishtit, Marshi i Kryqësimit dhe Kryqësimi*. Në poezinë *Anës lumenjve*, hero i prometeik nolian vjen në imazhin e të syrgjynosurit, (parabol për vetveten) si figurë mesianake, që paralajmëron lëvizjen e gjerë politiko-sociale që do të sjellë lirinë e vërtetë. Në këtë poezi konfirmohet në një regjistër të admirueshëm poetik veta prometeike. Sipas modelit titanik janë paraqitur edhe figura nga antikiteti grek dhe historia e Shqipërisë (periudha e viteve 20-të, kur vetë poeti ishte

protagonist në skenën politike shqiptare). Në imazhin heroik të lajmëtarit të fitores, që do të thotë lirisë, vjen Maratonomaku, i detajuar në përmasa titanike nëpërmjet hiperbolës: *Gryka si gjyryk të çfryn / Prej vullkani flag e tym* /. Po në përmasa të tilla titanike, duke shtuar edhe përmasën sociale, metaforizohen e detajohen edhe bashkëlloftëtarët e poetit, si Bajram Curri: *Dif dragoj i Dragobisë, / Trim tribun i Vegjëlisë. .../ Legjendar Ante po rritesh- /*, apo Luigj Gurakuqi: *Ky Vigan Liberator* /.

Konica, ndër të paktët që në esenë *Jeta dhe librat* sjell në vëmendjen e lexuesve figurën e Prometeut dhe vlerëson tragjedinë e Eskilit, në *Katër përralla nga Zullulandi*, vjen me historinë prometeike të Plugut, (edhe këtu parabol për vetveten) i cili, pas përpjekjeve të mundimshme për të zgjuar ndërgjegjen politiko-sociale të fisit të tij, Zulluve, përndiqet nga turma e paditur, që udhëhiqet nga demagogu injorant Deni Sepa Llupa dhe detyrohet të ngujohet në shpellë, duke përkuar në këtë mënyrë (ngjashëm si tek Noli) me mesianizmin social që kemi parë në variante evropiane.

Ndërsa hero i prometeik i Koliqit, edhe pse vjen nga Perëndimi me ideale të qarta dhe i vendosur t'i përkushtohet qytetërimit të mjedisit social konservator, nga ku ka origjinën, nuk arrin ta tejkalojë *Hijen e maleve*, duke mbetur thjesht një shembull argumentues i teorisë psikanalitike mbi rrënjët e moralit zakonor në subkoshiençë.

Përveçse tek Koliqi gjejmë imazhin e heroit lirik që mediton në majmalesh, ngjashëm me modelin prometeik, në *Pasqyrat e Narcizit* distanca perspektive romantike vjen ngjashëm edhe me modelin e Narcizit. Kështu sipërfaqja e pellgut të çuterit (kroit), pusit, liqenit, apo sipërfaqja e një pasqyre, imazhohet si hapësira informacioni mbi të cilin mediton hero i lirë, për të arritur tek rrënjët e tij etnike.

Edhe pse tek Migjeni vihet re predispozita prometeike e heroit lirik të angazhuar në lidhje me probleme të mprehta sociale, përgjithësisht ai nuk e tejkalon pesimizmin, duke mbetur figura e vetës poetike të pafuqishme përballë *malit që hesht dhe qesht* me të. Ai nuk arrin të shfaqet në përmasa titanike për ta tejkaluar këtë mal, nuk e tejkalon dot dhomën e erret dhe në vend që të gjejë brenda vetes pishtarin, kërkon dritë. Ndoshta qe sëmundja që e pengoi këtë zë poetik të fuqishëm denoncues, të arrijë përmasat prometeike. Nga ana tjetër sensi realist mund ta ketë penguar atë t'i referohet modelit romantik të heroit lirik, i konceptuar poetikisht ngjashëm me modelet mitologjike titanike.

Lasgush Poradeci e ndërton parabolën prometeike sipas modelit natyror dhe të Gjeniut. I pari mishërohet poetikisht në poezinë *Vdekja e Nositit*, nëpërmjet së cilës vetëflijimi poetizohet si rregull tragjik i vazhdimësisë së brezave. Ndërsa i dyti sendërtohet në poezinë *Gjeniu i anijes*, ku spikat akti vetflijues i Gjeniut për të hapur rrugë të pashkelura të filozofisë së triumfit mbi vështirësitë e jetës : *Se po të vazhden e ndritur- / Q'e hapa me shpirtin fatos:- / Fistonë gazmor ku pat shkitur / Valim-i anijes q'u sos. /*

Ky vështrim i shkurtër përgjatë dy periudhave të letërsisë shqipe, Rilindjes dhe Pavarësisë, është i mjaftueshëm për të konstatuar praninë e prometeikes si strukturë karakterizuese, e cila dëshmohej qartë nëpërmjet vetës së parë, topikës së sublimitimit të heroit lirik në maja malesh, kodrash, bregoresh, timbash etj, metaforës, dhe alegorisë, duke reflektuar një sens të qartë parabolik. Është pikërisht prania konstante e kësaj strukture, me të cilën lidhet fryma prometeike, që karakterizon letërsinë e këtyre dy periudhave letrare, në pikëpamje përmbajtësore, si një letërsi e angazhuar për ringjalljen e idesë kombetare (Rilindja) dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare (Pavarësia).

Bërthama e këtij angazhimi letrar është autori, i cili, përveçse transfigurohet brenda subjektit epik apo lirik më së shpeshti nëpërmjet vetës së parë, përndryshe vetës prometeike, edhe kur shprehet në vetën e tretë, e realizon këtë transfigurim nëpërmjet rastit autobiografik, si raport i vetës autoriale me masën, shoqërinë në një moment të caktuar historik. Pikërisht nga ky raport angazhues përftohet figura e autorit hero, misionar, për të ndriçuar e hapur perspektiva të reja kombëtare e sociale.



FITUESIT E "FONDIT MBËSHTETËS TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ"

NGA QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT DHE LEXIMIT

Ditën e enjte me datë 24 qershor, në ambientet e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit u mbajt ceremonia e shpalljes së fituesve të fondit mbështetës të krijimtarisë letrare për të rinj. Ky fond ndahet për shkrimtarë nën 35 vjeç dhe u mundëson botimin e një vepre në dorëshkrim.

Në fjalën e saj, ministrja e kulturës, zonja Elva Margariti, shprehu mbështetjen për nismat që lidhen me krijuesit e rinj, nisma këto të artikuluar dhe realizuar nga QKLL-ja që në krijimin e saj.

Juria, e kryesuar nga shkrimtari, dramaturgu dhe studiuesi Stefan Çapaliku si dhe gazetarja Arta Marku, mes 16 kandidatëve, zgjodhi 3 fitues, nga një në secilin zhanër:

- Në poezi:
Nurie Emrullai,
“Lëre dashurinë të vijë si të dojë”
- Në prozë:
Dionis Prifti, “Bar Sahara”
- Në dramë
Ledian Gjeçi, “Pak pakt”



NË POEZI:

Nurie Emrullai, “Lëre dashurinë të vijë si të dojë”

Motivacioni: Si autore e një poezie me theks të fortë bashkëkohor, të përpunuar mbi parime të kthjellëta estetike, spontane në figuracion dhe e strukturuar qartë në narracionin e vet.



NË PROZË:

Dionis Prifti, “Bar Sahara”

Motivacioni: Si autor i një tufë tregimesh, në të cilat realiteti nuk pasqyrohet, por interpretohet mbi parime surrealistike, me anën e një stili poetik dhe mjaft vetjak.



NË DRAMË:

Ledian Gjeçi, “Pak pakt”

Motivacioni: Si autor i një vepre të mirërealizuar në të gjithë komponentët e saj: tematikë e mprehtë, ndërtim solid karakteresh, konflikt i thekshëm dramatik.



THUAJA HËNËS

Poezi nga

Vehbi Skënderi

DËLIRËSI

Ti më zbulove një të fshehtë
Dhe unë të besova plot sekrete.
E pas një ore s'na kishte mbetur asnjë sekret për vete.
Asnjë!

E pas një ditë, nga hiçgjë
Ne ishim kthyer në dy pyje
Ku kish vend për burime, driza, zogj, lule, yje
Dhe ngelej një lëndinkë bosh, për ne të dy!

E pas dy orëve, tri ditëve, tri netëve, tri vjetëve
Kishim rrëzuar dhjetra mure
E nga dy pika uji kishim stisur dy dete
Pa shkurre, brigje, zaje e male midis...

(Dy dete të tejdukshm ku mund të vëreje përfund:
Një shkëmb, një breshkë, një karkalec
Dhe një cironkë të verdhë sa një guralec)!

E pas dy minutave:
Ne ishim dy armiq të betuar,
Që digjnim njëri-tjetrin me rrufe!

E pas dy sekondave:
Ne kishim harruar gjithçka.
Gjithçka kishim harruar!
Dhe ishim njerëzit më të lumtur mbi dhe!

BALADË PËR GISHTAT

Ja tek janë gishtat; gishtat e tu në ajër, mbi tavolinë.
Lëvizin pa qëllim. Lidhin një nyje, shtrihen sikur
flenë.
Tjerrin një velë reje fluturim. Ndryshojnë botën!

Më lëmojnë pak ballin e papandehur ikin.
Këtu ndezin një xixë, më tej një diell fikin.
Stisin me grep tantella: gjethishte, peshq, ëndërra me
fije peri.
Qepin këmisha nate nga mëndafshi i ylberit.

Mbjellin gëzim, mërzi! U bien telave të zemrës si
kitarë.
Mpleksin ca nyje të padukshme me erën. Bëhen dhe
vetë erë.
Qëllojnë mbi tastierat e ditëve si të marrë!
Shkërmoqin akullnajat pa u ndjerë.

Mpiksin ca shkarravina (nëpër ditët me shi) në xha-
mat e dritareve.
Bëjnë gjerdhan me pika shiu, e çelin lule molle.
Gatisin manikyrin me tymin e cigareve
Dhe, si të zënë në faj, fshihen si nxënës shkolle.

Numërojnë yjet; gurëzit e lumit; hedhin në lumë
rrjetin.
(Ata edhe yjet mund t'i kapin fill në rrjet!)
E zbresin hënën poshtë, si komardar në det.
Dhe vetëm me një shënjëz e qetësojnë detin!

Ku dridhen nga një dhimbje, ku lozin me një brum-
bull.
Gishtat e tu të bukur: s'ka shkrepitimë që nuk kapin.
Dhe po t'u flasësh pak, dhe po t'i frysh si flaut:
Mund të çuditin qiellin me tingujt që përhapin!

HARROVA

Kujtova se ti, e dashur, je pema erëmirë
Ku mund të çukë diçka dhe zogu, dhe korbi,
dhe ketri.
Harrova se ti qenke nusja e një tjetri;
gruaja...
Dhe unë jam ai gungaçi e bujkrobi,
që Zoti më ndalon të prek sendet e huaja.

Tiranë, 6 gusht 1994

VONESË

E ç'ndodh kështu me ne? Gjithnjë nuk kemi kohë.
Ngutemi gjithnjë! Për ku po fluturojmë, në shi edhe
në llohtë.

Dua të ngas drejt teje...
Herë pres që të gdhihet, herë pres që të erret.
Herë më ngjan sikur po nisem me vonesë.
Herë më ngjan sikur jam nisur shumë herët.

Pse gjërat kryesore, si gjithnjë, ia themi shoqi-shoqit
në mungesë?

Pse ndodh kështu? Fsheh, mbuloj, zbuloj diçka që s'ta
them dot
apo s'arrij?
Dua të jem me krahë, dua elikë reaktive
Dhe s'kam as këmbë breshke që të vij!

Jam unë, vallë, memec apo s'ke veshë ti të më dëg-
josh?
Ç'është ky mur kinez? Kjo humbëtitirë bosh, kjo dreq
pengesë!

Pse gjërat kryesore, ne, gjithnjë ia themi njëri-tjetrit
në mungesë?

Kam shumë të të them. Por nuk të flas. S'guxoj.
Druaj mos kanë fjalët thonj e të gërvisht.
Mos janë fjalët plumba e të vras!
Mos janë fjalët pupla e të mashtroj!

Dhe ngjarjet marrin tjetër rrugë. Tjetër kthesë.

Pse gjërat kryesore, si gjithnjë, ia themi shoqi-shoqit
me vonesë?


TANI TI JE E TËRA IMJA

Tani ti je e tëra imja, që nga kumbimi i hapit deri te
frymëmarrja. E di se pylli ngjizet nga thërrimja
dhe skaji i çdo takimi – ndarja. Tani ti je e tëra imja!

Vështrimi, buzëqeshja, era, vapa e ngricat; malet,
zajet,
grimcat, baticat e zbaticat, klithmat e dëshpëruara,
kënga e heshtja
kureshtja tinëzare; ëndrra. lindja, vdekja:

Je ti! Je ti! Je vetëm ti!

Çdo regëtimë e pulsit, çdo shushurimë e psherëtimë,
që kumbon
së thelli; lumi, vorbull e turbullt, lëngu e njomështira
e kërcellit; lulja që mbin në gur e lulja delikate në
tokën
e në botën e paqetë! Çdo flutur e çdo brumbull,



çdo milingtonë, grenëz, dhemje e bletë:

Je ti! Je ti! Je vetëm ti!

Dhe unë që buroj plot vrull lumej në fjalë dhe emëra
abstrakte.
E më pëlqen të hyj rrugicave e ngushticave (pa dritë)
të mistereve e shpellave me shumë kate:

Mbaroj për këtë trup! Këto duar e këto dy buzë
dhe këta sy të zes... që mbushin shpirtin tim plot tym
plot re dhe shkrepëtima.

Tani ti je e tëra imja!

Tiranë, 5 gusht 1994

MOS IK

Oh! Ti po nxiton të shkosh – pa ndenjur mirë në
karrike
Nuk po vëren ?
E mbushe krejt hapësirën bosh. Urbani shkon e vjen!

Të iki kush të dojë! Qoftë kjo mackë e vogël,
Që sa ndjeu erën tënde nisi të gërhitë.
Të iki ky trumcak që po çukit në xham. (Sikur kum-
ton diçka!)
Urbani shkon e vjen. Ka edhe tjetër urban.

Ti shkele zjarre perëndish!
Ti shembe mure qiklopikë – të vish këtu tek unë. Të
flasim pak.
Të rrish... të shpleksim që të dy flokët e tu të gjatë.

Të ikin trenat e vaporët oqeanikë. Të iki dhe kjo
gjethe
Në humbëtirën e pamatë.
Të rendin ku të duan nëpër qiell: marsianë, meteorë e
meteoritë.
Të iki dhe kjo melodi. Ndonëse këtë muzikë e dua
fort.
Ti rri edhe pakëz. Rri! Mos ik.

Të iki dhe ky shi i butë, që pikë-pikë mbush dhe
oqeane.
Dhe këta zogj shtegtarë, që udhëtojnë larg
Pa hipur në taksira dhe urbane.

Të iki dhe kjo erë, që çapet kaq me frikë, sikur po na
gënnen
Urbani shkon e vjen! Mos ik...

Njeriu për çdo ditë bën zbulime të mëdha.
Në Galaktikë po troket!
Po si nuk e shpiku dot ai një mjet,
Që këtë lumturi të gjallë, që mund të vërehet e të
preket.
Ta ndalë ! Mos e lërë që të ikë. Mos e lërë që të tretet !
Mos ik! Mos ik! Mos ik!

MOS I PËRBUZNI GRATË

Në buzë çelin lulen, në sy gruan e këngën
Në zemër e mbajnë diellin, në ballë mbajnë hënën.
I brejmë në çdo gjeth përditë pakngapakë,
I shkelim mbi vlastarët delikatë

Mos i përbuzni gratë! Mos i poshtroni gratë!

Na shkundin çdo mëngjes gërmadha plot me pluhu-
ra,
Na kthejnë fitimtarë prej luftërave të humbura
Në njërin krah shtëpinë, në tjetrin kalamajtë
E rritin bimësi dhe mbi një gur të thatë

Mos i përbuzni gratë! Mos i poshtroni gratë!

Gatitin papushuar darkë e drekë,
Po era e gjellës nis, diku, në treg;
Me thonj e grryejnë veten, kur u mungojnë paratë!
Dhe kur në dashuri nuk kanë fare fat...

Mos i përbuzni gratë! Mos i poshtroni gratë!

I kanë hapat puplëza të buta,
U buzëqeshin halleve të shumta:
Me neve bashkë ndajnë çdo kafshatë
(vuajtjet tona i bëjnë më jetëshkurtra)
Sikur dy jetë mjerimi ynë të zgjatë...

Mos i përbuzni gratë! Mos i poshtroni gratë!

Sanatorium, shkurt 1994



BËJMË SIKUR...

O flokëprerë e ëmbël! Përse nuk po të shoh?
Në gjithë zërat e pyllit unë zërin tënd e njoh.
Pres çastin të të vrej... dhe lus të jetë i gjatë.
Me cyrril ujvarash poema për ty thur!
Por, që të flasim drejt, pa i fryrë bririt të artë:
Thua vërtet më do, a bën sikur më do? Sikur, sikur...

Ashtu si çdo fillim, ti erdhe me dy mendje.
Thua më deshe fort? A u çmende nga mërzia
E hyre gabimisht mes ditëve të mia!
Dhe prap sa vure këmbë të mbyti zagushia...

E pse të përsëris përrallën: “Ish dikur”!
Thua vërtet më do, a bën sikur! Sikur. Sikur...

O burmë, që s’zë vend në asnjë ingranazh
E pse kur të shoh ty, besoj në çdo mirazh
Dhe nuk ka regullsi në Kozmos që nuk çthur!
Thua beson vërtet në këtë marrëzi e ndoshta yllësi, a

Bën sikur beson? Sikur. Sikur. Sikur...

Buburezë, shkrep diku dhe prapa natës ngecesh.
Nga ç’derë del kur shkon? Nga ç’portë vjen kur hyn?
Nga guri të kam gdhëndur a nga një fjollë tym?
Mos vallë je gënjeshtër: as flakë, as hije, as gur!

Thua më do vërtet, vërtet çmëndesh për mua?
A bën sikur. Sikur. Sikur...
Dhe as ti nuk më do. Dhe as unë nuk të dua! Veç
lozim komedi.

E nga kjo kotësi që ndesh ngado të shkosh:
Gjithçka të duket kot! Gjithçka të duket bosh!

Tiranë, mars 1994

SI TË TË QUAJ?

Si të të quaj?

Engjëll, magjistricë e Vagabonde?
Me ata sy të kthjellët
dhe atë përrua fjalësh:
Më bëre skllav në gjysmësekonde!
Në gjysmësekonde!

Dhe u trete...

Tani, unë shpeshherë rri flas me vete,
sikur edhe vetë drita m’u shua –
E pyes pareshtur gjithë tmerr:

Ku do ta ndesh sërishmi këtë grua?
Ku do ta kap këtë xixëllonjë nëpër terr?

Tiranë, 23 shtator 1992

QENKA ZOR TË DUASH...

Qenka zor të duash. T’i thuash një gruaje:

Unë vuaj!
Mezi pres të të shoh. Mezi pres të dëgjoj hapin. Të të
ndjej
frymëmarrjen. Qenka zor ta mbjellësh një lule e ta
shikosh
si vdes. Të kapësh një flutur, si një ëndërr e të vresh
si i shkërmoqen në duart e tua krahët.
Të sajosh një det e ta shohësh si thahet!

Qenka shumë zor të duash. T’i thuash një gruaje:

Mos ma pre me sëpatë këtë bli, këtë pyll.
Mos ma shuaj këtë zjarr. Këtë flakë. Këtë yll
që rrezëlliu, befas, në këtë ditë gri. Mos ma vraj
këtë xixëllojë, që më hyri kësaj buzëmbremjeje fshe-
hurazi
në shtëpi. Mos ma shuaj!

Mos ma merr sërish këtë buzëqeshje, kaq të afërt e
kaq të huaj,
që herë i ngjan një dasme, herë i ngjan një vdekjeje.
Unë vuaj.

Unë vuaj...

Tiranë, 4 gusht 1994

KOPSHTI I AKULLT

Poezi nga poetja argentinase

Teresa Palazzo CONTI

Përktheu Dashamir Malo

DOLLI

*Dua një dashuri të egër, të kthetrave dhe dhëmbëve
që do të më sulmojë pabesisht haptas ditën me diell.
Alfonsina Storni*

Unë jam martiri lidhur tek shtylla
duke u djegur në hijesirën tuaj.

Ti je kudo rreth meje,
dhe brenda zbrazëtisë sime,
ti më do dhe
përunjësisht

unë të lejoj të shpalosësh
devijimin tim.

Bujaria juaj tejshpon poshtë
plagës më të thellë
e cila nuk është më e juaja tashmë.

Do të ngre një dolli për ty
për praninë tënde
dhe një tjetër për veten time
të këtij momenti të vrullshëm.

Nëse ky është fundi
lë të jetë i përpiktë dhe i saktë
mprehe kristalin
dhe le të më derdhet gjaku
deri në pikën e fundit.

Sikur të ishin këto stade fjalësh
hajmalia më fisnike në himnin tim?

Unë ngre dolli në diell,
livadheve dhe breznive
dhe depërtoj në sytë e tu.

Dhe vetë vdekja ime.



BURGOSJE

Sot më në fund do ta lë derën hapur
dhe do ta lë veten të befasohet nga pafundësia e fjalës;
atë fjalë që donit ta linit të çlirët
kur faji dhe frika ju meku zërin.

Sot do ta lë shtëpinë hapur
të mund ta ndjej trokitjen e dorës tënde lypse;
ndoshta thjeshtësinë e dashurisë së ndershme.

Sot më në fund
do ta hap shpirtin
për të parë të derdhet
drita e lëbyrur e pikëllimit tim
duke lundruar në albumin me shëmbëllime të zbehta
në hapat e tua këmbëngulëse që nuk lënë gjurmë.

Sepse kjo është dashuria ime;
plaga prej të cilës mezi të vështroj ty
dhe gjaku im të ndjek
dhe dhimbja ime nuk do të pushojë.

Më në fund do të jetoj e lirë
për të parë atë puthje
të vjedhur në një natë vjeshte
rrokullisur mbi çdo pore të flashkët.

Dhe mandej do të vijë burgimi
dhe lëkura ime do të shndërrohet në mur
mbi të cilën do të shkruash me thonj
emrin tënd.



FLUTURIMI I KONDORIT

Më lidhe këmbët sot
më pengove,
dhe unë mezi ngrihem të të nuhas
në flladin që fryn.

Si në të shkuarën
kur ti nuk munde të ecje
kortezhi i vargjeve;
si më parë,
kur ti u rrëzove në mes të natës
zbulove trupin tim pa më paralajmëruar.

Në gjumin tënd, ti re në prehrin tim
dhe u krodhe në rrecka...
aq pak që munde të gjeje
midis trupit në nxitim e sipër.

Midis meje dhe teje
një udhë yjesh u hap
në mbarim të agsholit.

Dikush më vështroi me sytë e tu.

Dhe atëherë ti munde të buzëqeshje;
ky gazmend i bollshëm që ende të përshkon.

Ndoshta
unë kam fjetur në hijesirat e lashta

ndërsa ti lundrove mes zambakëve të lumenjve
të mi.

Nuk duhet të presësh më;
tani ti ke kopshtin tim dhe ferrat e mia;
Ne do të ngjitemi mbi mur për të parë mollët.

Unë do të jem kondori femër;
midis kthetrash dhe dhëmbësh
të gjitha puplat dhe sulmet.

Mos u druaj;
zhvishu edhe një herë;
më lejo të kërkoj brenda syve të tu
fluturimin që gjendet brenda meje
atë fluturim që ti ende nuk e njeh.

Do të të jap bisqet dhe frutin,
dhe puthje të panumërta
në sytë e tu; ishull;
shumë thjesht si njeri
si këto buzë që sapo të krijuan.



KOPSHTI I AKULLT

Harrimi zvarritet, i palëvizur.

Një grua në rrugë
dhe të gjitha manjolat vdesin në gjunjët e saj.
Engjëlli këmbëzbathur në sytë e saj
dhe një tkurrje e menjëhershme
murosje në skajet e mungesës.

I hapa sytë e saj në liqenet e kripës;
e prerë në pyetje;
e pandreqshme.

Fjalët
brazda të një kohe të ndërprerë.
Dhe unë u zhyta në tollivinë e kockave të saj
të ashpra.

Vetmitare e menjëhershme
e mbushur plot me mister.

Ajo endet në duart e mia duke kërkuar tokën
dhe unë rrëzohem përsëri
në thatësirën e orvatjes sime të fundit.



DHE ATJE ISHTE LUFTE

*Në homazh të ushtarëve në Luftën Malvine (Folklands),
Argjenitë 1982*

Pse zvetënim dhe grahma?
Pse kripësirë?
Zgripe të ngrira të etjes dhe pyetjeve.

Pse nënat janë duke qepur kryqe në uniforma;
pse këmbë dhe jo hapa,
duar në tokë,
gojë e hapur, xhepa bosh?
Letra të mallëngjyera dhe zhurma e fluturimit.

Pse grushti i përgjakur në zemër të rinisë?
Zgavra në lutje. Fjalë të gjunjëzuara.

Pse të gjithë emrat në sytë e shuar të fajit?
Duke fshirë lotët;
shpërthim i nxituar mbi pafajësinë.

Kush i nxiti trillimet e urrejtjes?

Kush i ngjalli sytë dhe qepallat e frikës?

Diku e qeshura u ndal.

Dikush mbylli dyert e dashurisë
dhe pati luftë.

UNË JAM TJETËR

Poezi nga poetja veneuzeliane

Yolanda Pantin

Përktheu Adrian Zalla

Shkrimtari është i vetëm

Shkrimtari është i vetëm,
i vetëm para vetes
i vetëm para botës
i vetëm para personit që dashuron
kjo e fundit i shtin drithmat
si i vetëm?
Mundohet të vendosë rregull mbi mendimet e veta
-Personi i dashur i ka sytë ngjyrë mjaltë
Shkrimtari ka një frikë titanike
Çfarë ndryshimi ka mes kësaj dashurie dhe një tjetre?
-personi i dashur e sheh nga thellësia e syve të vet-

Shkrimtari është i tmerruar

Dashuria damkos armën e vet kundra një fëmije



Qytetet e padukshme

“Qytetet, ashtu si ëndrrat, janë të ndërtuara mbi
dëshirat dhe mbi frikërat.”
Italo Calvino

Të shkruash mbi dashurinë
Sytë e qetë të Veronës
-poezia je ti-
Imagjino një qytet të padukshëm
si ajo
Të reflektosh mbi vdekjen
dhe fotografinë
Të jesh besnik dhe i vëmendshëm
Ndaj gjithçkaje që në të mohohet
Me dyshim,
i heshtur dhe ambig
kujto
-mbi të gjitha-
Që ajo që është e dashur
nuk ekziston



Paris II

Muzikë
në qiell
në veshë

në lëkurën e parakrahut

Do flemë këtë natë
me të kuqen e gjakut

etje

gjithçka ka vdekur

Unë jam tjetër

Kam pranuar ftesën për të udhëtuar.
Me makinë,
peizazhi kalon shumë shpejt,
gërvisht veshin
muzika e shurdhët në brendësi zmbrapset.
Kalojmë nëpër vend pa ndaluar,
veçse për të urinuar a për të pirë një gotë ujë
nëpër benzinata.
Vera ndëshkon gri dhe palëvizshmëri,
si qielli.
Biseda banale shpërqendrojnë rrethimin
nga orët e vdekura.
Ngritëm tendat
Buzë një lumi të gjerë e kënetor.
Zogjtë ulërijnë teksa ngrihen në fluturim.
I afrohem lumit
Si Narcizi pellgut.
Ujërat e turbullta nuk pasqyrojnë fytyrën time.
Unë kam ëndërruar me këtë.

(Plaga ishte shëruar mbi mishin e vdekur)



Odisea

-Nga vini ju?

-Larg
nga ai mall
që gjithmonë na lë gojëhapur
nga hapi i lehtë i fëmijëve, nga gjithçka
që frika kapërthen
në frymëmarrje

Ëndrrat

(Në gojën e natës)

Mjeku sheh
brenda syve të mi,

më bën të hap gojën

I tregoj ëndrra
kaloja në një pishinë me një fëmijë rreth qafës

Ndonjëherë më sulmon
Një uri e frikshme

Gllabëroj gjithçka gjej aty pranë meje

Mjeku dëgjon
zemrën time të rrahë

Tundi kokën
me shumë seriozitet

kunsultoi një libër
mbi tavolinën e tij

Jam e humbur

-Tashmë kishte parë brenda syve të mi-

Atëherë
Të iu tregoj një ëndërr tjetër

Jo e gjitha zemra ime të do
Vetëm pjesa që është e sëmurë



Bisedë në një banjo

Si zakonisht
shtrihet në shtrat
për të pritur burrin e saj
që vjen gjithmonë vonë
i thotë natën e mirë
mërzi

Ajo shkon në banjo
qetëson tërbimin
me dorën e saj mjeshtërore
mbështetur në peshqir,
kur ai hyn dhe pyet:
“Çfarë bën këtu?”

Asgjë, përgjigjet



TË BËRË E TË PABËRË

Tregim nga Ardiana Salihu

Emërkurë... dridhem, fërgëlloj... ndjej afshin e mbledhur gjatë javës, ndjej të më lëngëzohen sytë, dhe jo vetëm. Një shqetësi e pakontrollueshme më vërshon në tërë qenien. U dorëzohem përfytyrimeve të ëmbla e drithëruese: së shpejti *do t'ia bëj vetes* sërish! Kam vendosur t'ia bëj vetes një herë në javë. Pse jo, më zbavit dhe më pushton ethshëm forca e këtij përjetimi të cilin, për një kohë të gjatë, e pata ndryrë diku brenda meje si një tabù të shenjtë dhe, jo rrallë, e kisha kujtuar me lakmi të fshehtë, si një veprim të ruajtur vetëm për guximtarët e zgjedhur. E pranoj se mendimi "*t'ia bësh vetes*" më ka pushtuar egërsisht sidomos nga pandemia e këtej. S'është çudi, njerëzit duhet të merren me diçka në këto kohë të rënda. Qoftë edhe me gjëra që kalojnë ose çojnë në fiksime. Kudo që ndodhem dhe ngado që shkoj, më ndjek hija e këtij mendimi. Për shembull, shoh njerëz dhe mendoj: "do t'ia ketë bërë vetes, vallë? Apo: do t'ia ketë bërë dikush? Kur, ku për herë të fundit?" (Dhe, nuk ndruhem, as nuk ndihem në siklet, siç më ndodh, bie fjala, në ato çastet e pashpjegueshme kur, teksa ndjek politikanë apo figura tjera publike në media, nuk mund të përqëndrohem fare në ato që thonë, sepse, gjatë gjithë kohës, i përfytyroj duke e bërë...) Më "qetëson" ndoshta edhe fakti se kohët e fundit ky veprim është bërë modë e pranuar gjithandej rruzullit dhe praktikohet pa hezitim në mënyra e në vende nga më të ndryshmet: t'ia bësh vetes ndërkohë që të tjerë të shohin; t'ia bësh vetes ndërkohë që të tjerë presin pas derës, të ta bëjë dikush me dorën e vet e të tjerë të shohin a të presin para apo pas derës; madje një nga teoritë e shumta konspirative që zakonisht sjellin situatat e tilla, pretendonte se në firma dhe në institucione të caktuara po organizoheshin orgji të tëra *bëja vetes / bëja tjetrit*, ku turma njerëzish, në orare të prera me kujdes, me një çfilitje prej adhruesisht sektarë, prisnin në radhë plot shpresë e durim. Me një fjalë, gjithë e shumëçka po ndodhte dhe askush nuk po ndjente më se t'ia bëje vetes, a të ta bënte tjetri në publik, ishin gjëra të pazakonta. Përkundrazi, secili po ndihej disi i ngacmuar, por edhe i përmbushur në mënyrën e vet.

Unë, për veten time, kisha rezistuar një kohë relativisht të gjatë. Mbase, ngaqë jam mësuar të bëj heroin në gjëra krejt të pa kuptim. Ndoshta edhe sepse jam një person disi i tërhequr dhe nuk dëshiroj të hidhem ndër të parët në trendet botërore që, edhe ashtu, s'kanë të ndalur. Por, më në fund, edhe unë kam guxuar dhe nuk kam më turp (morali, morali...) as droje nga thellësitë e lëngëta brenda meje; dua t'i përkëdhel me ëmbëlsi, lehtë, ngadalë, lëmueshëm... Qysh në çastin kur çoj mendjen aty, ndjej se si më rrjedh lëng; së këtejmi nganjëherë kujtoj edhe ato femrat që qëllojnë në "ditët e tyre" kur ia bëjnë vetes, por që nuk duan t'ia dinë fare për këtë. Me të drejtë, sepse të gjithë / të gjitha e bëjnë edhe në "ato ditë", disa sosh kanë madje një ndjesi akoma më marramendëse gjatë ditëve në fjalë. Dhe, fatmirësisht do të vazhdojnë ta kenë.

Ah, përpak harrova ta përmend: pranvera ka nisë me ardhë. Sigurisht që aromat e saj do të më nxisin t'ia bëj vetes edhe më shpesh, që të flatroj pastaj plot lumtur nëpër rrugët, ndanë lumenjve, ndanë drunjve, të bëhem edhe vetë një si frymë e lehtë mes tyre, një si puthje e lëngët që mban aromë dehjeje lirie, teksa shikoj çapkënçe nëse në sytë e kalimtarëve lexoj pyetjen "t'ia ketë bërë vetes vallë?" dhe t'u përgjigjem po me sy: "mund t'ia kem bërë, mund edhe të mos ia kem bërë!"... Ndoshta e teproj, por, pas kaq kohe, më është mbushur mendja se mund t'i dalloj ata që e kanë bërë nga ata që nuk e kanë bërë. Më duket sikur mund ta lexoj nga niveli i frikës së tyre, kur ecin në rrugë, bie fjala, teksa çapiten përballë teje – ata që e kanë bërë ecin më lirshëm: bashkë me shumë gjëra të tjera, gjatë këtij rituali duket të kenë shkarkuar edhe turpin e mundshëm; për më tepër, këta jo vetëm që duken disi më krenarë, por edhe të shohin si sipëranë ndërsa hedhin shikimin drejt teje me qortim: "Po ti, ç'pret?" ose "Ke guxuar të dalësh pa e bërë? Turp! Papërgjegjësi!" dhe lakojnë trupin për të të qëndruar sa më larg, kjo ndoshta për faktin se këta *të bërët* priren rëndom të besojnë se janë të vetmit që e kanë bërë dhe sikur kanë frikë se i tërë mundi mund t'u shkojë huq nga një puqje e padiktueshme e hormoneve në ajër. Ca syresh nga ky soj largohen duke hedhur hapat si në një vallëzim amator dhe, në largim e sipër, lënë pas një nënqeshje dinake, sikur duan të të thonë se mbrëmë kanë parë fotot e tua lakuriq në internet; ca të tjerë largohen gati demonstrativisht, sikur të ishin në një marsh proteste, pa t'i shqitur për asnjë grimë shikimet gati vrastare që i drejtohen shkaktarit të të gjitha

të këqijave në botë... Kurse ata që potencialisht nuk ia kanë bërë vetes (tashmë sa kohë) duken pakashumë si unë: mundohen të mos bien në sy, por, pikërisht për këtë arsye, bien edhe më shumë; ata janë të kujdesshëm që (të) hiqen si të shkujdesshëm; padyshim gjithë kjo tendosje nuk është e lehtë për t'u bartur, sidomos nëpër vende publike. Edhe unë, bashkë me këta, jo rrallë luaj rolin e të lehtësuarve, por zakonisht aq ngathët, sa nganjëherë, edhe në ato raste kur t'ia kem bërë vetes vërtet, ndodh të harroj se si duhet të sillem dhe vetëm ngjall më shumë dyshime gjithandej.

Sidoqoftë, kam mirëkuptim për të gjitha palët, sepse është kohë e vështirë dhe një çmendi e lehtë kolektive vetëm sa i bën mirë kësaj klime. Tani, edhe ashtu, të gjithë janë disi njësoj më të jashtëzakonshëm, ose ia kanë dalë të maskojnë qenien e zakonshme aq mirë, sa të mos dallohen më. (Jashtë)zakonshmëria është përzier aq shumë, jo vetëm ligjet e shteteve ndërrojnë oreçast, por edhe tek ata të natyrës është thujasë vështirë të mbështetesh si dikur.

Nuk hezitoj të pandeh se edhe njeriu paskësh tronditur një sistem ligjesh të padukshme brenda vetes. Duke ia bërë vetes? Duke mos ia bërë? Tjetrit? Shumë shpesh? Shumë rrallë? Si flinin paskëtaj burrat me gratë e tyre dhe anasjelltas? Një e vërtetë shqetësuese ndërkaq, ishte edhe fakti se ky veprim fatal po krijonte varësi shumë shpejt. Te burrat dhe gratë, te burrat dhe burrat, te gratë dhe gratë. Edhe vetë e ndjej se po shndërrohem në një fanatik të "*t'ia bësh vetes*", dhe, sadoqë hëpërhë e bëj vetëm një herë në javë, rreziku se do të mund të filloj t'ia bëj si shtresa më e zellshme e shoqërisë në dy-tri, a ruana Zot, çdo ditë të javës, nuk është aspak larg. Fundja, nga të gjitha statistikatat e deritanishme del se, sa më shpesh që të bëhet, aq më e lumtur është shoqëria, madje pa marrë parasysh nëse rezultati i së bërës të kishte dalë i kënaqshëm ose jo për individët veç e veç. Pastaj, në rastet e shumë çifteve, për shembull, kjo dukej se po sillte edhe risi të bukura në jetët e zbehura të shtratit... (Pra, tani edhe ata partnerët që, deri atëherë, ia kishin bërë vetes



tinëz dhe kryesisht në rastet kur nuk kishin ndër tërheqjen e duhur drejt tjetrit, nuk kishin më nevojë ta fshihnin këtë dëshirë, përkundrazi, mund t'ia bënin vetes sa herë e ku të donin e madje edhe ta shkëmbenin këtë përvojë me tjetrin, gjë që bëhej zakonisht me një si mburrje gati-gati feminare. Kishte edhe zëra që parashikonin se njerëzimi po shkonte drejt shuarjes, ngaqë gjithnjë e më shumë çifte po e pëlqenin artin e të përmbyturit nga njëri-tjetri, madje edhe nga ai tjetri / ajo tjetra...) Tani rëndësi kishte se si ndjehej shoqëria në përgjithësi, dhe, po të ndjehej shoqëria e lehtësuar, detyrimisht edhe individët do të kishin përfitimet e veta. Për një shoqëri të tillë do të kenë ëndërruar breza të tërë, padyshim, pra, për një shoqëri që e shtyn individin t'ia bëjë vetes sa më shpesh dhe, si rrjedhojë, të lumturohen të paktën edhe disa, për të mos thënë edhe shumë të tjerë. Sigurisht, këto gjëra nuk do të kishin lezetin e tyre e as nuk do të ishte aq e lehtë të bëheshin, sikur të mos përkraheshin nga vetë shtetet, gjegjësisht qeveritë e tyre. Anekënd botës. Ose më dukej mua kështu.

Me sa mbaj mend, në fillimet e veta, shteti, me gjithë pushtetin nuk ia bënte gjithsecilit, mirëpo, me t'ua bërë disave, një pjesë e madhe e shoqërisë vërtetë vërente pasojat e lehtësimi. Më vonë, shteti jo vetëm që ua kish lejuar këtë gjë të gjithëve pa përjashtim, madje edhe femijëve, por kishte zënë edhe t'i motivonte të gjithë pjesëtarët e shoqërisë që ta bënin sa më shpesh, ku e kur të mundnin. Disa gojë të liga pohonin ndër dhëmbë se shteti dhe shoqëria, më së voni me paraqitjen e këtij fenomeni, ishin shkrirë në njëri-tjetrën a njëra-tjetrin. Ky pohim mbështetej dita-ditë edhe në faktin se shteti dhe shoqëria po nxinin njerëzit deri edhe të mbylleshin në shtetë pa çarë kokën për detyrimet qytetare dhe t'ia bënin vetes me aq sa kishin mundësi. Si rrjedhojë, gojëligat spekulonin akoma më guximshëm, se, së shpejti, "të pabërë" nuk do të guxonin ta hidhnin hapin as matanë pragut (ata të pastrehët as brenda) shtëpisë. Por gojë e liga nuk ishin të vetmet që kujdeseshin për të përhapur shqetësime e trazira ndër njerëz. Një gjë e akoma më e çuditshme, që u pikas gjithandej rruzullit në mes të kësaj turbullire globale, ishte një si ngritje peshe e mediave: këto, përkundër, madje përkrah gjithë hallevet të shtuara të përditshmërisë, të rrëmbyera nga një ekzaltim mistik, kishin nxituar ta ngjyrosnin (domethënë t'ia bënin vetes a të tjerëve) këtë gjë sa më politikisht. Kjo qasje, sikur po ua rikujtonte njerëzve se politika vazhdonte të mbetej një shturje e pazëvendësueshme e llojit të vet.

Nga ana tjetër, etja e shoqërisë për lehtësim nuk kishte të ndalur, ndaj edhe shteti, më në fund, u shtrëngua t'ua mundësonte njerëzve që t'ia bënin vetes, tanimë edhe pa ndonjë shtysë a urdhër, madje edhe pa ndonjë arsye për të qenë. Për më tepër, për të pabërë do të hartoheshin rregulla, ndalesa, ndëshkime, kufizime, pra, shteti nuk dëshironte dhe nuk do të lejonte kurrësi që qytetarët ta zgjidhnin të pabërë me vullnetin e tyre të lirë. Gojëligat e mësipërme, u ndjenë sakaq të përmbushura dhe filluan të flisnin për ca manuale të përcudshme lidhur me dy a tri mënyra të vetme të lejueshme për t'ia bërë vetes e që shumë shpejt do të dilnin në qarkullim. Thuhej se nga qeveria ishin sajuar edhe metoda profesioniste përmes të cilave mund të zbulohej fare lehtë nëse dikush po ia bënte vetes sipas shembullit të dhënë, dhe, në rast se jo, kjo duhej përsëritur, me gjithë sikletin e mundshëm përcjellës. Çka nënkuptonte se kulmeve të shtirura po u vinte fundi, mbase përgjithmonë. E pra, të imitoje bëmat e qeverisë qoftë edhe ato më të voglat nuk ishte aq e thjeshtë, sadoqë në të parë a me të dëgjuar mund të dukej çuditërisht shumë lehtë për t'u mësuar.

Mbaj mend kur të ngarkuar të qeverisë ma bënë mua për herë të parë: isha kapluar nga një si frikë e pandalshme, një si siklet *uuu* sa i rëndë, sepse, ngaqë i isha shmangur kësaj gjëje, ndjehesha fort e pasigurt. Dua të tregoj edhe një gjë, sepse kjo s'ka më asnjë rëndësi për shtetin e as për shoqërinë: deri në çastin e përmendur kisha bërë dredha të pabesueshme për t'i ikur këtij urdhëri nga lart e që atëbotë edhe do të mund të më kishte kushtuar jo pak. Prandaj, në këto çaste, po dridhesha si purtekë jo vetëm nga ngazëllimi i fillestarit, por edhe nga frika se mos do më zbulonin që kisha qëndruar një kohë të gjatë "e pabërë". Sigurisht që e dija se herët a vonë do të më vinte radha edhe mua. Por se do të vinte dita kur një gjë kaq intime të ndodhte në një shesh publik s'e kisha çuar mendjen kurrë, jo kurrë! Më parë do të kisha vrarë veten, ose do të hiqja dorë nga të gjitha përfitimet e shtetit a të shoqërisë, se sa ta bëja këtë!

Më vjen turp të rrëfej se si ndodhi e tëra në detaje (sidomos shikimet e afshëta pyetëse të njerëzve rrotull më pas), por për çfarë më vjen shumë, shumë turp, është ta pranoj se, po ta bëri qeveria një herë me dorë të lehtë, ashtu siç ma bëri mua për herë të parë, rreziku për të kërkuar edhe më shumë është mëse i sigurt dhe ti je mëse i mbaruar. E sado që mundohem t'i heq nga mendja skenat e ndodhisë, preket e lëngëta brenda meje nuk mund t'i tres dot: edhe sot e kësaj dite i ndjej me po atë afsh e me të njëjtën frikëz si në çastet kur kishin ndodhur. Të mos përmend pastaj përfytyrimet gjatë çasteve kur unë... ia bëj vetes... gati... njësoj...

Me duart që më dridhen do t'ia bëj vetes sot. Së pari, do t'i laj duart me kujdes: sado e çmendur të jem pas lëngjeve të mpiksura, mjaltëpista të kurmit të afshët, duart dua t'i pastroj më parë... (Lëre pastaj që na është bërë edhe fiks i pashmangshëm.) Por unë e bëj këtë para së gjithash, sepse dua të ndjej sa më thellë çdo gjë... është një ndjesi e ëmbël alarmuese që fëshfëritet mes lëkurës së lehtë dhe mendimit se tashmë e di që do ta bëj: kam gjithë ç'më nevojitet, kam

kohën, kam edhe vendin të tërë për vete, kam zjarrin bashkë me shqetësimin e ndrydhur qyshkur... Më pritet, por disi edhe s'më pritet, një dykuptimësi magjike dhe frikëbukur lëvron nga brenda qelizë më qelizë, teksa ndjesia nxiton të shkrihet në ngrohtësinë e heshtur të diellit që përvidhet tej xhamit të dritares – po, pse jo në mëngjes: më ka pushtuar një dëshirë nga ato të mëngjesit, në dukje të fshehura aq mirë, por në të vërtetë aq ngathtë nën lëkurë, sa mjafton një prekje, shpesh edhe një shikim, madje edhe një grimcë mendimi që ta shpalosë deri në thellësinë më të paturpshme e që ta nxisë të marrë rrugën e ëmbël drejt puqjes misterioze...

Mëngjes është, pra, qoftë i bekuar, që më mban në kulmin e ndjesisë, në kulmin e drithërimave çuditërisht të panjohura më parë, i kam mbyllur sytë përgjysmë dhe hamendem një çast, t'i mbyll perdet apo jo, *hëëm*, vendos t'i lë të lëshuara disi në mes... Zvarritem përtueshëm tek dritarja, dua ta festoj këtë kumt në ardhje me një ofshamë të bukur, pa le ta dëgjojnë ata që krimben pas derës e të tremben një çikë, (po, jam mësuar ndërkohë t'ia bëj vetes edhe kur ka të tjerë rrotull, për të mos thënë se pasioni është edhe më i vrullshëm në këto raste – unë, që dikur isha një fanatik i mbrojtjes së integritetit të njeriut e sidomos i intimitetit të tij, tani po jetoja një pritje të thellë, vetëdorëzuar me një kënaqësi morbide syve e veshëve voajeristë të atyre që nuk ua di as emrat...) po s'mundem ndryshe, dua të shturem në çastet e shumëpritura të një jave pa fund. Tani nuk kam më ndjesi as dëshirë për ndonjë gjë tjetër...jam zhytur në jermin e shumëpëritur të lojës me duar, me gjuhë, me lëng, me... Nuk më duhet as edhe një ndihmesë nga jashtë (madje as nga qeveria), jam fare brenda në elementin tim, ia kam bërë vetes disa herë në këtë mënyrë, nuk jam ngopur kurrë deri në fund, përkundrazi, jam etur për edhe më shumë, për edhe më shpesh; *ah*, e ndjej se shumë shpejt do të nis t'ia bëj vetes të paktën dy herë në javë... E ndërsa duart e mia prekin ngadalë, dridhshëm e me kujdes gjithë çfarë mund të arrijnë e ndjejnë, herë ftohtë, herë ngrohtë, sipërfaqe të lëmuara, të buta, të forta, ca klithma pëshpëritëse nga hera e parë përzihen në ajër: kujdes, mos e fut menjëherë, prit, hidh ngadalë ca pika lëng, të lutem lage sa më shumë, sa më thellë, kujdes, lëvize lehtë... pranë gjuhës, shtyje në brendësi... ja ashtu, sa më thellë, sa më lagësht, ashtu, ja edhe pak, hë, jepi... përzieji të dy lëngjet tani, atë të gojës dhe atë të... pikërisht, ja ia dole, më në fund...

Disa fëshfërima të mbrame përzihen me ca dromca pëshpëritjesh nga jashtë dhe, sakaq, bie një qetësi e pabesueshme, e padurueshme. Vërej se sytë i kam hapur. Ç'ka nuk shkon kësaj here? Kam mbetur e stepur dhe më duket sikur për herë të parë dyshoj në të fshehtat e kësaj kënaqësie të (pa)përsëritshme. Fjalët e lëngëta më derdhen edhe njëherë të turbulluara nëpër tërë trupin. Qeveria më ngjeth. Është e mundur të kishte arritur deri këtu, me forcën dhe me pushtetin e fjalës? Teksa mendoj këtë, ndjej si rrallë më parë një varësi të pashërueshme. Mos! Me fjalë nga më të ndryshmet po na e bënte qeveria tash e qyshkur dhe po na nxiste t'ia bënim edhe vetë vetes! Dhe kushedi se me çfarë fjalësh do të na ketë pasur në dorë deri më tash dhe me çfarë sosh do të na ketë mbase përgjithmonë... Jo, më nuk jam e sigurtë nëse breza të tërë do të ëndërronin për një shoqëri të tillë, ku shumë a gjithçka mund të lëvizet a ndalet vetëm përmes një fjale të folur nga (një a disa) njerëz – kjo forcë a nuk do të duhej të ishte vetëm e Perëndisë? O Zot! Ky mendim më kthjellon çuditshëm, sytë tashmë i kam katër. Shoh veten dhe, për një çast, e kuptoj se duhet të mbuloj pjesët e turpshme të trupit: shikoj rrotull, kap një cohë të lënë mbi tavolinë dhe mbuloj me të gojën... si s'po gjindej dot një fjalë aq e bukur sa ta mbulonte turpin ose një turp aq i bukur sa ta mbulonte fjalën? Nga dëshpërimi mezi marr frymë...

Mirëpo forca e ëndjes, shkaktuar nga duart e mia dhe nga fjala e qeverisë, më err sytë rishtas dhe unë vazhdoj të përçartem mes një risie që më fanitet mes grilave të dritares si një ëndërr, por që ka të ngjarë edhe ta kem dëgjuar a lexuar diku... Qeveria na paskësh përgatitur një kënaqësi edhe më të epërme, më të afshët, më të thellë... nuk do të ishte më, të më falni për shprehjen, një masturbim i thjeshtë, por... një penetrim... një penetrim i fuqishëm, që thuhej të ishte aq trandës, sa mund të na ngrinte dhe gjakun në vena. Që do të thotë pakashumë se, do s'do, shteti herët a vonë duhet të ta fusë, në njëfarë mënyre... Psherëtitj pavullnetshëm. E di, s'kam bërë aspak mirë që u kam dhënë udhë gjithë atyre mendimeve gjatë këtij çasti kaq të shenjtë: ia kam bërë vetes duke harruar se *çfarë ta bën vetja, s'ta bën askush* dhe tani mundohem të sjell ndërmend tërë zhgënjim se kur paskam arritur të mbaroj kaq shpejt. Kam mbetur as ulur, as shtrirë në një si pritje që, fatkeqësisht, pas gjithë këtyre (pë)shtjellimeve, më ngjan disi shumë e zakonshme. Çfarë pres? Mos e kam harxhuar tërë magjinë, edhe të pritjes, teksa po ia bëja vetes ndër gjithë këto mendime? Kohë më parë, pikërisht kjo pritja *paskëtaj* ishte, si të thuash, një si kulmim i dytë, ishin ato çastet frikëngazëllyese përzier me drojën e lehtë se çfarë do të të lexojnë të tjerët në sy pasi t'u dalësh përpara. Por më duhet ta pranoj se, kësaj radhe, këto pasndjesi po vijnë duke u zbehur e po rrezikojnë të rrëthqasin në njëfarë perceptimi të mefshtë, gati-gati negativ. Dhe, vërtet, pasi pesëmbëdhjetë minutat kanë kaluar tashmë, i afrohem tavolinës dhe shoh se teshi i shpejtë antigjen i covidit që ia bëra vetes edhe kësaj të mërckure, ka dalë, fatmirësisht, negativ. E hedh në shportë me të gjitha mbetjet tjera dhe nisem për në zyrën ngjitur, ku më pret puna.

PORTRETI

Tregim nga Roland Gjoza

Filloi stina e shirave dhe ne mblidheshim mbrëmjeve te kafe Van Gog. Atë e kishte një piktor manierist, i çmendur pas Van Gogut, një piktor tejet interesant, që kishte sukses me galeritë e famshme të Parisit, Athinës dhe Los Anxjelesit. Atë natë isha vetëm. Porosita fërnnet branka dhe shikoja përjashta shiun në kopsht. Ai u ul pa u ndjerë prane meje, duke thithur çibukun e madh prej shqope. Dukej i menduar. Vështronte dhe ai shiun që breronte me ferrmim përjashta dhe përplasej pa zhurmeë në xhamat e mëdha të dritareve. Në krye mbante një beretë të zezë me pipth përsipeër, në llapën e veshit kishte ngecur një lule dielli prej floriri, një miniaturë e përsosur, e punuar nga ndonjë dorë mjeshtri.

-- Ke patur rast të njohësh ndonjë femër krejt teë veçantë? me pyeti me një fill zëri.
-- Krejt të veçantë? Pyetje e vështirë. Po, edhe kam njohur.
-- Të kanë bërë përshtypje, i ke kuptuar deri në fund, ta marrë dreqi, ta marrë, se këtu qëndron e keqja, secili shikon te një objekt atë që i intereson, prandaj lindin keqkuptimet... i dashur, ne, ose e zbukurojmë botën, ose e shëmtojmë, pothuajse asnjëherë nuk e gjykojmë siç është. Kam një dhomë në shtëpi, që i thonë dhoma e diplomatit. Nuk të duket e çuditshme?

Në atë dhomë ka një kavalet dhe në atë kavalet qëndron një pikturë, një portret gruaje. Po le t'ia nis nga fillimi. Kur u ktheva nga Parisi, nuk më besuan që i kisha shitur të gjitha pikturat, të 36-të peisazhet dhe portretet. Pastaj kur u ktheva nga Los Anxhelesi dhe ju tregova gazetat që shkruanin për mua, si një fenomen post impresionist, e kaluan në heshtje. Megjithatë fama kishte marrë dhenë.Të parët e dëshmuar kushërinjtë, më dolën nja dyqind kushurinjtë të varfër që kërkonin para borxh. Piktoret me emër, ca të shtetur prej kohësh, që s'u kishte ecur, më sollën disa punë, që i mbanin për kryevepra, për t'ua treguar galeristëve të Parisit. Ku nuk ju shkonte mendja, budallenjve, u dukej sikur unë, batakcïu, s'do t'i merrja fare me vete pikturat e tyre, nga frika e konkurimit dhe do t'i mashtroja. Bleva një kamera të mirë dhe i filmova. Këtë gjë bëra dhe atje, se e dija çdo të më gjente me ata Rembrante e Goja të pafat. Nuk thonë kot, fati të çon deri te dera e galerisë, po brënda duhet talenti. Kur u ktheva e futa kasetën në video dhe ata panë dhe dëgjuan se ç'u tha nga kritikët për pikturat e tyre të dhjera. I bëra armiq për vdekje. Po kjo ma rriti famën. Më vinin porosi nga të huaj. Çmimet ishin të kripura. Mund ta quaja veten pa frikë milioner. Paraja nuk më hynte në sy. Gruas i bënin përshtypje. Të them të drejtën, mbeta piktor. Punoja çdo ditë. S'më linte as menaxheri me telefonatat e tij të përditshme. Menaxheri im është një amerikan nga Teksasi, një djalosh i ri, një batakcï i aferave të rrezikshme. Me të s'më ka dalë keq. U mbylla brënda. Punoja orë pa orë. Nje ditë erdhi diplomati me gruan e tij. Ra zilja disa herë dhe më në fund gruaja e hapi portën dhe i ftoi të hynin brënda. Isha i pa rruar, i rraskapitur, nervoz, kundërmoja nga boja e vajit, duhani, pisllekü. Kisha disa ditë pa u larë. Flija pak orë në kanapenë e studios.

Burri ishte një biond i dobët me syze miopi. Për çudi ai dukej tejet i emocionuar. Sytë e zgjuar sapak cinik dukej sikur lëvrinin me zhdërvjelltësinë tinzare të një miushi. Kostumi i prerë me shije të holleë i rrinte për bukuri, po nuk ia mbulonte dot dobësinë, atë shëmti, që nuk fshihej dot. Gruaja, një grua e re, ishte tejet simpatike, një nga ato gratë e bukura që kanë mbushur romanet e famshëm, me aq finesë dhe sharm delikat, sa ne nuk i harrojmë dot. Mos ishte një Irene Forsajt? Apo një Margaritë Gotje? Mos ishte një zonjë Bovari?

Ajo më dha dorën duke buzëqeshur dhe nuk e fshiu njollën e bojës, që i mbeti në mollëza, ndërsa i shoqi, e fshiu për një kohë me shami. Ajo ishte e shpenguar, merrte c'ti tekej, nga piatancat me fruta dhe ëmbëlsira. Piu verë të kuqe burgonje dhe më foli për retë. S'i pushonte goja, ajo gojë e madhe sensuale, e tultë, e kuqe, si e lëngshme, që të ftonte të bëje marrëzira. Ky ishte modeli që pëlqeja. Mu ndez gjaku. O zot, këto lloj femrash nuk duhet të jenë kaq të rralla. Arti pa mëkat nuk ngjiz. Më avulloi lodhja, gjendja e rëndë nervore, isha gati të shkalloja. Ai, i shoqi, një fatlum hajdut, që na i kishte vjedhur këtë Venus, që rëndom flirton nën yjet e artistëve, rrinte si mbi gjëmba, sikur e ndiente veten të tepërt. Ajo kishte ditëlindjen. Mbushte 28 vjeç. I pëlqente pa masë piktura. Ishte e çmendur pas impresionistëve francezë. Ajo më kishte zgjedhur mua, donte një portret prej meje.

Ajo kishte veshur një kostum të karfosur, një bluzë të mëndafshhtë me kravatë të gjerë, geta, këpucë me taka të larta. Flokët i kishte mbledhur me karfica. Lëkurë e brydhtë, e lëmuar, hijet e qerpikëve mbi mollëza, sytë, ah, ata sytë aq të ëmbël e dinakë prej djallushke.. jo, jo, diçka s'po më pëlqente, ajo kishte një paraqitje prej gruaje diplomati. Une do ta kisha xhveshur, do ta kisha lënë vetem në një këmishë të hapur që i zbulon thuajse përgjysmë hiret, flokët do t'ia çliroja nga karficat dhe do t'ia derdhja mbi supe.. Po sytë e të shoqit, që lëvrinin brengosës, sa nga e shoqja tek unë, nuk do të ishin të një mendjeje me një propozim të tillë. Ishte e kotë. Megjithatë unë jam idiot. E them atë që më vjen. E thashë me një valë pasioni që më tradhtoi. Sytë e tij u zmadhuan me një hutim prej fatkeqi. Si thua, iu drejtua ajo, gati t'ia shpërthente një të qeshure skandaloze. Kështu më pëlqen më tepër, tha ai. Kaq. U përqëndrova te portreti i saj, mrekullitë përplot mister të fytyrës së saj, te sytë, te goja, balli, flokët, hunda, mollëzat, lëkura, shprehja lojcake, vështrimi i drejtpërdrejt, pa komplekse, dëlirësia dhe mëkati.

Portreti mbaroi, mbeti dhe një seancë e fundit, më tepër një lexim i fundit, ata do të merrnin portretin, ende të pa tharë mirë, ndërsa unë do të fusja në xhep 2000 dollarë. Gjatë seancave më bënte përshtypje sjellja e tij tejet e kujdesshme ndaj së shoqes, një delikatesë nervoze, një hutim dhe frikë e çuditshme, aq sa më dukej më tepër si një truproje, se sa si burri i saj.

Ai erdhi vetëm. U ul në karrigen e saj dhe e këqyri për një kohë të gjatë. Nuk tha asnjë fjalë. Nuk e mori portretin. Erdhi sërish pas një jave, u ul në të njejtin vend dhe e pa portretin e saj për një kohë të gjatë. Se si më dukej dhoma, tani, pa gruan e portretit, pa imazhin e saj, që s'vinte, sa herë ishte ai aty, e thërrisja me mend, po ajo nuk donte, që nuk donte të shfaqej. Vetëm kur ikte ai, ajo pikonte, kështu më dukej, sikur pikonte nga yllësitë e artistëve bohemë dhe ishte kaq e ëmbël dhe delikate, qeshte ngapak, kur e shikonte portretin, se bukuria e saj bënte përshtypje, po kjo nuk donte të thonte se ajo ndjehej e mikluar, apo e përkëdhelur fshehtas në sedrën e saj prej gruaje të bukur. Ajo ishte e thjeshtë dhe gati e pavëmendshme, nuk i kushtonte kujdes efektit tronditës të hireve të saj tek të tjerët.

Më falni, ju lutem, më tha ai, mund të vi ta shoh përsëri një herë tjetër? Sigurisht që pranova. Ai erdhi. U ul para saj dhe, si zakonisht, e këqyri për një kohë të gjatë. Ai filloi të vinte një herë në javë, të martave, dhe unë e lija vetëm në dhomë me portretin. Mos i kishte vdekur? Jo, nuk dukej se ishte kjo. Mos ia kishte mbathur me ndonjë tjetër? Mos kishte shkuar në vendin e saj dhe i kishte çuar një pusullkë lamtumire? Po ç'ishte ky mall e kjo dashuri prej të marri? Ai e donte, vinte dhe e shikonte në mungesë. Nuk kishte në qëndrimin e tij, as urrejtje, as zhgënjim, po përqëndrim, vetëm një përqëndrim zhbirues dhe asgjë tjetër. Ai ende s'më kishte dhënë paratë. Më në fund, i nxitur nga ime shoqe, e pyeta për gruan. Ku ishte ajo? Ndoshta më shpëtoi një mbresë banale e një kurioziteti jo fort prej ndjenjës, po prej zakonit.

Ai më pa me sytë e tij të zgjuar, që i lëvrinin prapa lenteve prej miopi, me një grimë nervozizmi dhe sikleti, sikur s'gjenin vrimë ku të fshihehin dhe lëshoi një psherëtimë; Ju keni qëlluar ku duhet, sepse keni parë në portretin e saj, atë që unë s'e kisha zbuluar, i dashur, prandaj vij dhe e shikoj kaq shpesh..Ju e keni trajtuar psikologjikisht..keni depërtuar te shpirti i saj, unë s'isha mësuar ta shikoja kaq thellë, s'më interesonte..Ah!..

Kaq tha ai dhe u largua.Nuk erdhi më. Unë e pres. Portreti i saj qëndron atje, në atë dhomë, ku unë ndërroj lulet, portreti i saj është ekspozuar dy herë në Londër, Paris dhe Los Anxheles, është pëlqyer shumë, por unë nuk e kam shitur..sepse e pres..e pres, atë, gruan e bukur. Sepse edhe une jam në lojë, befas dhe unë rrezikova pa pasojë, veç duke vuajtur njëfarësoj, po gjithsesi me një vuajtje artisti, është një frymëzim brengosës, prej një loje krejt të fshehtë, si të thuash, kam rënë brënda. Rri dhe unë si i shoqi dhe e këqyr gjatë. Më është bërë ritual. Nuk e riprodhoj, jo, s'ia fal askujt këtë kënaqësi. Dhe mendoj sa herë ndahem prej portretit, oh, s'ka si pritja! Ndoshta arti prej pritjes u perfeksionua. Jo prej takimit. Më mirë të mos vijë. Jo, më mirë të vijë. Si të duket, mik? Sa herë bie shi, si ky shi i kaltër nate mbi kopsht, më kujtohet ajo dhe ma shtërngon zemrën diçka si me darë, me një trishtim të ëmbël, më duket sikur do ta gjej atje, jo portretin e saj, që nuk lëviz nga kavaleti, po atë vetë. A do të vijë? Si mendon ti? A do të vijeë? Sa herë kthehem në shtëpi, më është bërë zakon të mprehë shqisat e t'i vë veshin mistikës së artistit; hap derën e dhomës së diplomatit dhe I hedh një sy mugëtirës ku shpresoj të gjej një siluetë, të paktën një siluetë..Pastaj ulem para portretit dhe mbetem pa frymë. Jo rrallë, prej marrëzisë sime, ajo sikur ngjallet, është gati të më flasë.. A do të vijë?

Dëgjonim shiun që binte me brerim mbi kopsht dhe shikonim xhamat e mëdha mbushur përplot vija gjarpërushe uji dhe vetëtima që shkrepnin në sterrnajë me drita flakëruese, por pa gjëmim.

TË NGRATËT PËRKTHYES TË MIRË

Gabriel García Márquez

Përktheu nga origjinali spanjisht nga Mira Meksi

Dikush ka thënë se të përkthesh është mënyra më e mirë për të lexuar. Mendoj se është edhe më e vështira, më mosmirënjohësja dhe më e keqpaguara. Traduttore, traditore, është shprehja e stërnjohur latine, që do të thotë se ata që na përkthejnë na tradhetojnë. Maurice-Edgar Coindreau, një nga përkthyesit më inteligjentë dhe të papërtueshëm të Francës, ka bërë ca rrëfime që të cysin të mendosh për të kundërtën. “Përkthyesi është majmuni i autorit” është shprehur duke perifrazuar Mauriac-un dhe duke dashur të thotë se përkthyesi është i detyruar të bëjë të njëjtat gjeste dhe të mbajë po ato qëndrime si autori, i pëlqejnë ose jo. Përkthimet në frëngjisht që u bënë romancierëve amerikanë, të cilët asokohe ishin të rinj e të panjohur, Faulkner, Dos Passos, Hemingway, Steinbeck – jo vetëm që janë rikrijime mjeshtërore porse futën në Francë një gjeneratë historike ndikimi i së cilës te bashkëkohësit evropianë – duke futur këtu edhe Sartre-in dhe Camus-in është fare i dukshëm. Kështu që Coindreau-ja jo vetëm që nuk qe tradhtar por, përkundrazi: një bashkëpunëtor gjenial. Ashtu siç kanë qenë përkthyesit e mëdhenj të të gjitha kohërave, kontributi personal i të cilëve lihet në heshtje, ndërsa mangësitë e tyre zmadhohen.

Kur lexon një autor në një gjuhë që nuk është e jotja, ndjen dëshirë pothuaj natyrale për ta përkthyer atë. Është e kuptueshme, sepse një nga lezetet e leximit – njësoj si muzika – është mundësia për ta ndarë atë me miqtë. Ndoshta kjo shpjegon që Marcel Proust-i vdiq pa përmbushur një nga dëshirat e tij të mëdha, që ishte përkthimi nga anglishtja i dikujt që e kishte habitur, i John Ruskin-it. Dy nga shkrimtarët që do të më kishte pëlqyer t’i përktheja vetëm nga kënaqësia e të përkthyerit janë Andre Malraux-ja sot vlerësimin maksimal të bashkatdhetarëve të tyre. Porse, asnjëherë nuk shkova më tej se dëshira. Nga ana tjetër, ka shumë kohë që përkthej pika-pika “Këngët” e Giacomo Leopardi-t, por e bëj këtë punë fshehurazi, orëve të lira që më mbeten, dhe duke qenë fort i ndërgjegjshëm se nuk do të jetë kjo udha që do të na shpjerë drejt lavdisë as Leopard-in dhe as mua. Por edhe vetëm kjo përpjekje më ka mjaftuar për të kuptuar se sa e vështirë është dhe me sa devotshmëri kërkon ta ndash bukën me përkthyesit profesionistë.

Ka pak të ngjarë që një shkrimtar të kënaqet me përkthimin e një vepre. Në çdo fjalë, në çdo frazë të romanit ndodhet, pothuaj gjithmonë, një kuptim i dytë i fshehtë, të cilin vetëm autori e di. Prandaj, sigurisht është e udhës që shkrimtari të marrë pjesë me sa mundet në përkthim. Një praktikë e shkëlqyer në këtë drejtim është përkthimi i jashtëzakonshëm i “Ulysses” i James Joyce-it në frëngjisht. Dorën e parë të gjithë përkthimit e bëri August Morell-i i cili më pas punoi për variantin përfundimtar me Valery Larbaud-in dhe vetë Joyce-in. Doli një kryevepër, të cilën – siç thonë dëshmitarë të mençur – e ka tejkaluar një grimë përkthimi në portugalishten e Brazilit i Antonio Houiass-it. I vetmi përkthim në kasteljançe pothuaj nuk ekziston, por historia që ka, i shërben si ndjesë. E bëri thjesht për qejf argjentinasi J. Salas Subirat, i cili për zanat kishte financat. Botuesi Santiago Rueda në Buenos-Aires, e zbuloi në një orë të ligë dhe e botoi aty nga fundi i viteve dyzet. Salas Subirat-in e njoha disa vjet më vonë në Caracas, qepur pas një tryeze shkrimi të paemërt të një kompanie sigurimesh dhe kalova me të një mbrëmje të mrekullueshme duke folur për romancierët anglezë, të cilët ai i njihte pothuaj përmendësh. Hera e fundit që e pashë ngjan si ëndërr: ishte duke kërcyer, tashmë i thyer në moshë dhe më i vetmuar se kurrë, në valën e çmendur të karnavaleve të Barranquilla-s. Qe një përshfaqje aq e çuditshme, sa që nuk e mora në sy ta përshëndesja.

Të tjera përkthime historike janë ato që bënë në frëngjisht Gustav Jean-Aubrey dhe Phillip Neel-i të romaneve të Joseph Conrad-it. Ky shkrimtar i madh i të gjitha kohërave – që në të vërtetë quhej Theodor Joseph Conrad Korzeniovski – kishte lindur në Poloni dhe i ati kishte pasë qenë përkthyes i shkrimtarëve anglezë, midis të tjerëve edhe i Shakespeare-it. Gjuha bazë e Conrad-it ishte polonishtja, por që fëmijë ai mësoi frëngjishten dhe anglishten dhe arriti të shkruante në të dyja gjuhët. Sot e konsiderojnë, me të drejtë ose jo, si një nga mjeshttrat e gjuhës angleze. Rrëfejnë se ua bëri të padurueshme jetën përkthyesve të tij franceze duke u rrekur t’u impononte përsosmërinë e tij, por asnjëherë nuk vendosi të përkthente librat e tij.

Është shumë e çuditshme, por nuk ka shumë


shkrimtarë dygjuhësh që ta bëjnë këtë. Rasti më i njohur për ne është ai i Jorge Semprun-it, i cili shkruan të njëjtën gjë në spanjisht dhe në frëngjisht, por gjithmonë veç e veç. Asnjëherë nuk përkthen veprat e tij. Më i çuditshëm akoma është Samuel Becket-i, që ka marrë çmimin “Nobel” të letërsisë, i cili shkruan dy herë të njëjtën vepër, njëherë në frëngjisht dhe njëherë tjetër në anglisht. Është e njëjta vepër në dy gjuhë, por autori i saj këmbëngul se njëra nuk është përkthim i tjetres, porse janë dy vepra të ndryshme në dy gjuhë të ndryshme.

Përpara dy vjetësh, gjatë verës zhurritëse të Pantelarias, përjetova një praktikë enigmatike përkthimi. Konti Entico Cicogna, që ishte përkthyesi im në italisht gjersa vdiq, po përkthente në ato pushime romanin “Parajsa” të kubanit Jose Lezama Lima. Jam një admirues i devotshmëm i poezisë së tij, ashtu si kam qenë edhe i personalitetit të tij të rrallë, ndonëse nuk kam patur shumë raste për ta takuar dhe asokohe kisha dëshirë ta njihja më mirë prozën e tij hermetike. Kështu që u vura t’i jepja një dorë Cicogna-s, sidomos në ndërmarrjen e vështirë të deshifimit të prozës sesa në përkthimin e saj.

Atëherë e kuptova se, në të vërtetë, të përkthesh është mënyra më e thellë për të lexuar. Midis të tjerash gjetëm një frazë, kryefjala e së cilës ndërronte gjini dhe numër disa herë në të paktën dhjetë rreshta, gjer në atë pika sa, në fund, nuk merrej vesh as se cili ishte, as se kur dhe ku ishte. Ndoshta kishte mundësi të vihej rregull, porse kjo gjë të bëhej vetëm me lejen e Lima-s, por asnjëherë nuk arritëm ta pyesnim. Pyetja që bënte Cicogna ishte nëse përkthyesi duhet të respektonte në italisht atë çakërdisje gjuhësore apo duhej t’ia nënshtronte atë rreptësi akademike. Mendimi im ishte se duhej të ruhej gjithçka në mënyrë që vepra të transmetohej në gjuhën tjetër jo vetëm me virtytet, por edhe me të metat e saj. Kjo është një detyrë besnikërie ndaj lexuesit në një tjetër gjuhë.

Për mua nuk ka kureshtje më të mërzitshme se të lexoj përkthimet e librave të mi në të tre gjuhët që kam mundësi ta bëj. E gjej veten vetëm në spanjisht. Por kam lexuar disa nga librat e mi të përkthyer në anglisht nga Gregory Rabassa dhe më duhet të them se gjeta disa pjesë që më pëlqyen më shumë se në spanjisht. Duke lexuar përkthimet e Rabassa-s të ngjan se ai i mëson së pari përmendësh librat në spanjisht dhe më pas fillon dhe i rishkruan ato në anglisht: besnikëria e tij është më e shumëllojtë se letërsia e thjeshtë. Asnjëherë nuk jep shpjegime në fund të faqes – mjeti më i paefektshëm dhe, për fat të keq, më i përdoruri nga përkthyesit e dobët. Shembulli më i spikatur në këtë drejtim është ai i përkthyesit brazilian të njërit prej librave të mi, që për fjalën *astromelia* dha si shpjegim në fund të faqes: lule imagjinare e shpikur nga Garcia Marquez-i. Ç’është më e keqja, më pas, lexova, nuk di ku, se astromeliat jo vetëm që ekzistojnë, siç e dinë të gjithë, në Karaibe, porse emri tyre është portugez.

“E gjej veten vetëm në spanjisht. Por kam lexuar disa nga librat e mi të përkthyer në anglisht nga Gregory Rabassa dhe më duhet të them se gjeta disa pjesë që më pëlqyen më shumë se në spanjisht.





nga **DITARI I NGASHNJYESIT**
Søren Kierkegaard

Zgjedhi dhe përktheu: Fatmir Alimani

Unë jam një estet, një erotik që ka depërtuar te natyra e dashurisë, te thelbi i saj, që beson te dashuria dhe që e njeh atë thellësisht, dhe kjo njohje më rezervon opinionin personal se një aventurë dashurie nuk zgjat më shumë se gjashtë muaj, dhe që gjithçka mbaron mbasi të kemi përfutur edhe prej favoreve të saj të fundit. Unë e di mirë gjithë këtë histori, por di gjithashtu që kënaqësia më e lartë e imagjinuar është të jesh i dashuruar, të jesh i dashuruar mbi gjithçka. Të hysh si një ëndërr në mendjen e një vajze të re, ky është një art, ndërsa të dalësh prej saj kjo është një kryevepër.

Mjedisi ka gjithmonë një rëndësi të madhe, mbi të gjitha për shkak të kujtimit. Të gjitha marrëdhëniet erotike duhet të jenë përjetuar në atë mënyrë, që të jetë sa më i lehtë evokimi i një imazhi me gjithçka të bukur në to. Përpara se të përjetohen ato, duhet bërë kujdes, mbi të gjitha për mjedisin.

Duhet një pjekuri e madhe nëse duam të miklojmë. Nganjëherë duhet të vendosemi mbi një pedestal tepër të lartë, por në mënyrë që të mbetet edhe një pedestal tjetër më i lartë. Nganjëherë duhet të shfaqim fare pak nga vetvetja. Për një qëllim shpirtëror udha më e mirë është e para, për një qëllim erotik, e dyta.

Erotizmi shpirtëror dallohet nga erotizmi fizik.

Dashuria është tepër thelbësore për t’u mjaftuar me llomotitje, dhe situatat erotike janë tepër të rëndësishme për t’u përmeshur. Ato janë të heshtura, të qeta, ato janë konture të përvijuara qartë dhe megjithatë ato janë shprehëse si muzika e kolosit të Memnonit. Erosi bën gjeeste, ai nuk flet, por edhe nëse e bën këtë, atëherë është fjala për nënkuptime misterioze, të një muzike imazhesh. Situatat erotike janë gjithmonë ose plastike ose piktorale, por nëse dy dashnorë flasin së bashku për dashurinë e tyre, kjo nuk është as diçka plastike e as piktorale.

Është mashkulli që duhet të flasë, prandaj rrjedhimisht ai zotëron njëfarë force magjepsëse me të

cilën shërbehet Venusi: biseda dhe miklimi i ëmbël, ose për ta thënë më mirë, miklimi i tërthortë. Dhe pastaj, nuk vijon fakti që Erosi të jetë i shurdhër, as përfundimi se nga ana erotike, qenka jo korrekt zhvillimi i një bisede, por që ajo duhet të jetë vetë erotike dhe jo të humbasë në diskutimet moralizuese mbi perspektivat e së ardhmes; dhe gjithashtu të konsiderohet në thellësi si një pauzë e veprimit erotik, si një kalim kohe, dhe jo si e mira supreme. Një confabulatio e tillë është në thelb krejtësisht hyjnore dhe prandaj nuk ia lejoj vetes kurrë ta bisedoj me një vajzë të re. Le të kuptohemi, unë mund të lodhem sa të dua me një vajzë të re në veçanti, por kurrë të bisedoj me të. Dhe kjo do të ishte për mua një gjë po aq e thjeshtë, sa edhe të marrurit frymë pa u lodhur.

Përqafimi, a mos është gjithashtu një luftë?

Nëse nuk do të kisha arritur t’i jepja bisedës përreth tavolinës drejtimin e duhur, unë do të isha mjaft i interesuar për të qenë i pranishëm në çastin kur do të mbërrinte letra, për ta konfiskuar atë. Ajo do të hynte në sallon dhe do t’i duhej të gënjente pakëz. Dhe janë këto gjëra që e përforcojnë misterin erotik, pa të cilin femra nuk mund të ndjekë udhën e përvijuar për të.

Atëherë ajo duhet të më magjepsë nëpërmjet të njëjtave mënyra me të cilat më ka shërbyer, domethënë me anë të erotizmit.

Liria nuk gjendet përveçse brenda kontradiktave. Dashuria nuk e ka rëndësinë e saj askund tjetër, përveçse atëhere kur një i tretë dyshon, dhe vetëm në këtë rast dashuria gjen lumturinë e saj, pra kur të gjithë të tretët mendojnë se të dashuruarit urrejnë njëri-tjetrin.

Femra, e pasur përjetësisht nga natyra, është një burim i pashtershëm për reflektimet dhe vëzhgimet e mia. Ai që nuk ndjen nevojë për këtë lloj studimi, mund të jetë cilido dëshiron në këtë botë, përveç një gjëje: ai nuk është estet. Shkëlqimi, hyjnorja e estetikës,

qëndron pikërisht te trajtimi i asaj që është e bukur, prandaj po ta gjykojmë thellë, asaj nuk i mbetet gjë tjetër, përveçse të merret me letrat e bukura dhe me seksin e bukur.

Bukuria femërore është e pjestueshme deri në infinit.

Unë përpiqem ta mendoj femrën brenda një kategorie të përcaktuar, po në cilën? Në atë të dukjes.

Femra është një dukje. Por këtu nuk duhet të turbullohemi nga leksioni i përvojës që thekson, se ne nuk mund të takojmë, përveçse shumë rrallë një femër që të jetë vetëm dukje, sepse ekziston përgjithësisht një numër i madh syresh që nuk janë asgjë, as për veten, as për të tjerët. Përveç kësaj, ato e ndajnë këtë fat me gjithë natyrën, me një fjalë, me gjithçka femërore. E gjithë natyra nuk është gjë tjetër veçse një dukje, jo në kuptimin teologjik, ku një element i veçantë i saj do të jetë i tillë për një element tjetër të veçantë, por e gjithë natyra është një dukje për mendjen tonë. Të njëjtën gjë mund të themi për elementët e veçantë. Jeta e një bime, për shembull, paraqet me një mënyrë krejt naive hiret e saj të fshehura, dhe nuk është asgjë tjetër përveçse një dukje. Po kështu, një enigmë, një gjë a gjëzë, një sekret, një zanore, etj., nuk janë asgjë tjetër, përveçse dukje. Kjo shpjegon gjithashtu faktin që Zoti duke krijuar Evën, e vuri në gjumë të thellë Adamin, sepse femra është ëndrra e mashkullit. Kjo histori na mëson gjithashtu në një mënyrë tjetër, që femra është një dukje. Sepse është thënë që Jehovah i heq gjithnjë njeriut diçka. Nëse ai, për shembull, do t’i hiqte mashkullit një pjesë të trurit, femra do të vazhdonte të ishte dukje, por qëllimi i Jehovahit nuk ishte të bënte një kimerë. Ajo u bë prej mishi dhe gjaku dhe për këtë arsye ajo bie pikërisht nën përcaktimin e natyrës, pra esencialisht është një fenomen. Ajo mund të zgjohet vetëm nga kontakti i dashurisë dhe përpara kësaj kohe nuk është veçse një ëndërr. Por në këtë ekzistencë mund të dallojmë dy stade: së pari, dashuria ëndërron për të, pastaj ajo ëndërron për dashurinë.

Femra është substancë, burri është reflektim. Prandaj ajo nuk zgjedh paraprakisht, por mashkulli e kërkon dhe atëhere ajo zgjedh. Por duke e kërkuar, ai nuk bën gjë tjetër përveçse një pyetje, ndërsa zgjedhja që bën femra nuk është gjë tjetër përveçse një përgjigje. Në një kuptim, mashkulli është shumë më tepër se femra, në një tjetër kuptim, ai është pafundësisht më pak.

Çasti është gjithçka dhe brenda këtij çasti femra është gjithçka - por rrjedhojat e kapërcejnë inteligjencën time.

A mos ka ikur një herë e mirë koha e metamorfozave? Përgjigje: A mos ka ikur vallë, koha e dashurisë?

Ne nuk mund të imagjinojmë diçka më pak erotike sesa dërdëllisjet për të ardhmen, që lindin sidomos nga fakti, që ne nuk mund të meremi me asgjë tjetër.

Nëse nuk e dimë se në ç’pikë duhet të vihem i në raport me shpirtin e një vajze të re, është më mirë të mos duam kurrë të joshim askënd, sepse atëherë do të jetë e pamundur të shmangim këto dy pengesa: të jesh i pyetur për të ardhmen, dhe të bësh leksion për besueshmërinë.

Unë ndodhem kudo i padukshëm.

Çfarë dashuron dashuria? Një vend të rrethuar? Po edhe parajsa vetë, a nuk ishte një vend i rrethuar, një kopësht i Lindjes?

Çfarë dashuron dashuria? Pafundësinë. Kujt i frikësohet dashuria? Kufinjve.

Çudi si është mbushur natyra plot me shenja parashikuese! Unë i shoh këto shenja te fluturimi i zogjve, te klithjet e tyre, te kërcimet e peshqve mbi sipërfaqen e ujit, në arratisjen e tyre në fund të thellësive, te një lehje e largët, te zhaurima e largët e një karroce, te jehona e një hapi që vjen nga larg. Unë nuk shoh fantazma, nuk shoh çfarë i përket së kaluarës, por gjirin e liqenit, trëndafilin e njomë, mjegullën që mbulon tokën dhe fsheh në përqafimin e saj të frutshëm, atë që do të vijë, për të ma treguar vetëm mua. Gjithçka është imazh, unë jam miti i vetvetes, sepse a nuk fluturoj unë si një mit drejt këtij takimi? Por cilido qofsha: unë i kam harruar të gjitha gjërat e përfunduara dhe kohore, vetëm e përjetshmja më përket, fuqia e dashurisë, dëshira e saj, bukuria e saj.

Po të isha perëndi, do të bëja atë që i bëri Neptuni nimfës, do ta shndërroja në një mashkull.

VEHBI SKËNDERI

thuaja) hënës



Onufri Poezi